



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 434 Akti

Nr. 528 Vendimi
Tiranë, më 6.5.2022

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Xhensila Pine	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, në datat 29.4.2022 dhe 6.5.2022, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancë dëgjimore publike çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Arian Ndoja**, me detyrë prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenet A, Ç, DH, E dhe Ë të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;**

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin e çështjes nga ana e relatores, mori në shqyrtim çdo provë dhe dokument të vënë në dispozicion nga organet kompetente ligjore, shpjegimet dhe provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit Arian Ndoja, si gjatë hetimit administrativ ashtu edhe në parashtrimet e tij në ushtrim të barrës së provës, si dhe, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Arian Ndoja, është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).

2. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin të Pavarur të Kualifikimit”, është zhvilluar shorti në datën 16.12.2019, në përfundim të të cilit, rezultoi që subjekti i rivlerësimit Arian Ndoja do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit, nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Olsi Komici, Xhensila Pine dhe Valbona Sanxhaktari, kjo e fundit si relatore e çështjes, ndërsa anëtar zëvendësues është caktuar komisionere Firdes Shuli. Në datën 17.12.2019, komisionere Valbona Sanxhaktari ka paraqitur dorëheqjen nga procesi i rivlerësimit të subjektit Arian Ndoja. Me vendimin e datës 20.12.2019, trupi gjykues i shortuar me vendimin nr. ***, datë 18.12.2019, të Komisionit, për shqyrtimin e dorëheqjes së komisioneres Valbona Sanxhaktari, pranoi kërkesën e saj për dorëheqje dhe, për rrjedhojë, kjo komisionere u zëvendësua nga komisionerja Firdes Shuli.

3. Për këtë subjekt rivlerësimi u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.

4. Me vendimin nr. 1, datë 27.12.2019, trupi gjykues, i përbërë nga komisionerët Olsi Komici Xhensila Pine dhe Firdes Shuli, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit Arian Ndoja, duke u bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisionerin Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, pasi është njohur me përbërjen e trupit gjykues, subjekti nuk është shprehur mbi gjendje konflikti interesi me anëtarët e trupit gjykues.

5. Me vendimin nr. 2, datë 24.3.2022, referuar pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, trupi gjykues vendosi mbylljen e hetimit administrativ për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja, vetëm për kriterin e kontrollit të figurës dhe atë të vlerësimit profesional, bazuar në rezultatet e hetimit administrativ për këto dy kriterë, duke i kaluar subjektin barrën e provës sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, apo duke i kërkuar sqarime të mëtejshme në lidhje me disa konstatime.

6. Në datën 5.4.2022, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit administrativ bazuar në kriterin e figurës dhe atë të aftësisë profesionale; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, për të dhënë sqarime mbi konstatimet e Komisionit, jo më vonë se data 26.4.2022; si dhe (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

7. Në datën 26.4.2022, subjekti i rivlerësimit dërgoi me anë të postës elektronike shpjegimet e tij dhe dokumentacionin shoqërues mbi rezultatet e hetimit administrativ, ku parashtrohej edhe një kërkesë për të thirrur dhe pyetur si dëshmitare shtetasit e përmendur në rezultatet e hetimit.

8. Me vendimin nr. 3, datë 27.4.2022, trupi gjykues, pasi shqyrtoi kërkesën e subjektit për të thirrur si dëshmitar çdo shtetas të përmendur në rezultatet e hetimit, vendosi të rrëzojë këtë kërkesë, sipas parashikimit të germës “a”, të pikës 6, të nenit 49, të ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e provës është konsideruar e panevojshme.

9. Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, me vendimin nr. 4, datë 27.4.2022, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja në seancë dëgjimore.

10. Në datën 29.4.2022, u zhvillua seanca dëgjimore, në të cilën subjekti i rivlerësimit ishte i pranishëm, i shoqëruar nga av. L. U., me licence nr. *** dhe NIPT ***, caktuar me prokurë të posaçme nr.***, datë 13.4.2022.

11. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti paraqiti tri kërkesa: (i) pjesëmarrjen në seancën dëgjimore të këshilltarëve ligjorë që kanë punuar me çështjen; (ii) administrimin e regjistrimit *audio* dhe *video* të seancës dëgjimore; si dhe (iii) pranimin e disa provave shkresore të cilat nuk ishin depozituar me parashtrimet e datës 26.4.2022. Ndërsa në përfundim të seancës dëgjimore, subjekti ka kërkuar riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e pasurisë.

12. Në lidhje me këto kërkesa, trupi gjykues është shprehur me vendime si vijojnë:

12.1. Me vendimin nr. 5, datë 29.4.2022, trupi gjykues: (i) rrëzoi kërkesën e subjektit për prezencën e këshilltarit ligjor me argumentin se kjo nuk është kërkesë për marrjen e ndonjë prove në kuptim të nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, duke iu referuar, gjithashtu, edhe jurisprudencës së Kolegjit të Posaçëm të Apelit¹, sipas të cilët këshilltarët nuk janë figurë procedurale e procesit të rivlerësimit, pasi veprimtaria e tyre është e një natyre këshilluese/ndihmëse dhe jo detyruese; (ii) rrëzoi kërkesën e subjektit të rivlerësimit për regjistrimin me *video* të seancës dëgjimore, për arsye se seanca dëgjimore mbahet vetëm në *audio*, e cila do t'i vihej në dispozicion subjektit²; (iii) pranoi kërkesën e subjektit për depozitimin e disa dokumenteve shkresore, të cilat u administruan nga sekretaria gjyqësore në përfundim të seancës dëgjimore dhe u bënë pjesë e dosjes.

12.2. Me vendimin n. 6, datë 4.5.2022, trupi gjykues, gjatë procesit të vendimmarrjes, rrëzoi kërkesën e subjektit për riçeljen e hetimit administrativ edhe për kriterin e pasurisë, për shkak se subjekti nuk kishte arritur të kundërshtojë plotësisht barrën e provës për dy kriteret e tjera.

II. PARIME TË PËRGJITHSHME TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

13. Procesi i rivlerësimit i kryer nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

14. Parashikimet e ligjit nr. 84/2016 kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera, parime që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

¹Shihni vendimin nr. 22, datë 16.9.2020, të KPA-së.

²Në datën 10.5.2022, subjekti ka marrë pranë ambienteve të Komisionit CD me *audio* të seancës dëgjimore.

15. Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin në lidhje me kontrollin e figurës. Në kreun VI të ligjit nr.84/2016, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale të subjekteve të rivlerësimit dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

16. Referuar vendimit nr. 2/201721 të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr.84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, ka kryer një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi për të dyja kriteret e përfshira në rezultatet e hetimit administrativ, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

III. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

Mbi kontrollin e figurës

17. DSIK-ja ka dërguar raportin nr. *** prot., datë 2.11.2017, mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Arian Z. Ndoja, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 4.4.2022, të KDZh-së, sipas të cilit konstatohej përshtatshmëria për vazhdimin e detyrës. Në zbatim të dispozitave ligjore të Kreut V të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka kryer një hetim të pavarur dhe të thelluar, në lidhje me kriterin e figurës së subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja, duke kryer verifikimet si vijojnë.

18. Gjatë hetimit administrativ iu kërkua DSIK-së përditësimi i informacionit të marrë nga të gjitha agjencitë ligjzbatuese për këtë subjekt dhe, më pas, nëse do të kishte vend, të bëhej rishikimi i raportit fillestar.

19. DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 1.12.2020, vuri në dispozicion të Komisionit raportin e rishikuar mbi kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja, i deklasifikuar pjesërisht me vendim nr. *** prot., datë 9.12.2020, të KDZh-së, në përmbajtje të të cilit referohet se: *“Në vijim të informacioneve të ardhura nga institucioni i verifikimit, në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit për përfshirje në korrupsion pasiv të subjektit të rivlerësimit Arian Z. Ndoja, në disa raste rezulton se:*

- gjatë periudhës në të cilën z. Arian Ndoja ushtronte detyrën si prokuror, në vitet 2018-2019, dyshohet se ka ushtruar ndikim të paligjshëm, duke favorizuar persona me precedent penal;

- për prokurorin Arian Ndoja, disponohen të dhëna, ku vihem në dijeni se në vitet 2009 – 2010 ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

Autoritetet verifikuese informojnë, gjithashtu, se:

*- shtetasi A. L. (P./L. M., ‘***’) evidentohet si lidhje bashkëpunuese e Arian Ndojës, i cili sinjalizohet se është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit aktiv, si dhe ka ndikuar në caktimin e trupës gjyqesore në një proces civil, për një çështje pronësie, për favorizimin e një pale;*

*- në ngarkim të shtetasit A. L., alias P. M. (‘***’), administrohen të dhëna të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për përfshirje/pjesë e krimin të organizuar ...;*

- po kështu, shtetasisinjalizohet si lidhje e pakonfirmuar e Arian Ndojës dhe dyshohet si lidhje e personave të...

*Për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja, referuar burimeve të hapura mediatike të datës 1.11.2019, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në zonën e Sh***, ku subjekti i rivlerësimit mbeti i plagosur nga një atentat me armë zjarri, rezulton se ka qenë i shoqëruar në makinë me shtetasin A. L., lidhje shoqërore e z. Arian Ndoja. Ky shtetas, rezulton të jetë person me precedent penal dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Aktualisht kjo ngjarje është në hetim nga ana e Prokurorisë së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.*

Në vlerësim të të dhënave që disponohen nga autoritetet verifikuese për subjektin Arian Ndoja, arsyetojmë të merren parasysh elementët që evidentojnë përfshirjen e tij në veprimtari korruptive dhe në veprimtari të kundërligjshme, të kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, pasi në frymën e ligjit nr. 84/2016, vlerësohet se integriteti profesional është përcaktues për pastërtinë e figurës së subjekteve të rivlerësimit”.

Në përfundim, Grupi i Punës i DSIK-së ndryshoi konstatimin fillestar, nga *përshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës në *papërshtatshmëri* për vazhdimin e detyrës, për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja.

20. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti iu kërkua të japë sqarime në lidhje me konstatimin e DSIK-së.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit në lidhje me raportin e dytë të DSIK-së

21. Në parashtrimet e tij, dërguar në rrugë elektronike në datën 26.4.2022, subjekti ka deklaruar se ky raport vjen në kundërshtim të hapur me dispozitat ligjore në fuqi të Aneksit të Kushtetutës, ligjin nr. 84/2016, si dhe jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese³, si nga ana procedurale, ashtu edhe nga ana materiale, duke ngritur pretendimet si vijojnë:

22. Në pikëpamjen procedurale, sipas subjektit, raporti i DSIK-së i referohet të dhënave që i përkasin periudhave kohore 2009-2010, si dhe 2018-2020, nga të cilat asnjëra nuk i përmbahet periudhës së vlerësimit të përcaktuar shprehimisht në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, i cili parashikon se: *“Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklaramit, sipas ligjit”.* Gjithashtu, subjekti pretendon se rishikimi apo përditësimi i raportit është bërë pa bazë ligjore dhe tej afateve të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, DSIK-ja brenda 60 ditëve duhet të verifikojë dhe të hartojë raportin për subjektin e rivlerësimit. Përtej këtij afati është përcaktuar shprehimisht një afat 10-ditor për dërgimin e këtij raporti përfundimtar pranë Komisionit.

23. Në pikëpamjen materiale, sipas subjektit, raporti i dytë i DSIK-së, i cili është i bazuar në dyshime dhe në lajme mediatike, është i pambështetur në prova dhe në ligj⁴ dhe ndryshimi i tij ka ardhur si rezultat i ngjarjes në nëntor të vitit 2019, si dhe ndërhyrjeve të pushtetit ekzekutiv. Konkretisht, subjekti ka parashtruar se:

23.1 Duke iu referuar raportit të dytë të DSIK-së, në të cilin citohet se *gjatë periudhës në të cilën z. Arian Ndoja ushtronte detyrën si prokuror, në vitet 2018-2019, dyshohet se ka ushtruar ndikim të paligjshëm duke favorizuar persona me precedent penal,* subjekti pretendon se ky raport është i bazuar në dyshime dhe në lajme mediatike.

23.2 Lidhur me konkluzionin se *për prokurorin Arian Ndoja, disponohen të dhëna, ku vihemi në dijeni se në vitet 2009 – 2010 ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar,* subjekti ka parashtruar se në raportin e parë dërguar Komisionit të vitit 2017, ky fakt nuk ka qenë pjesë e tij, por është shtuar pas përditësimit të kryer me qëllim për ta bërë raportin më të besueshëm. Pra, sipas subjektit, përveç se raporti i referohet periudhës përpara vitit 2012 nuk jepet asnjë e dhënë konkrete për kontaktet e papërshtatshme dhe mënyrën se si janë realizuar këto kontakte.

³Nenet Ç dhe DH, të Aneksit të Kushtetutës, nenet 34, 35 dhe 39 të ligjit nr. 84/2016, si dhe vendimi nr. 2/2017, i Gjykatës Kushtetuese.

⁴Neni 49/4 i ligjit nr. 84/2016, përcakton se: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit e bazojnë vendimin e tyre vetëm në dokumentet nga burime të njohura, në prova të besueshme ose që janë në pajtueshmëri të dukshme me provat e tjera. Ata kanë të drejtë të çmojnë, sipas bindjes së tyre të brendshme, çdo indicie në tërësi lidhur me rrethanat e çështjes”.*

23.3 Lidhur me konkluzionin se shtetasi A. L. (P./L. M., “***) evidentohet si lidhje bashkëpunuese e Arian Ndojës, i cili sinjalizohet se është përfshirë në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e korrupsionit aktiv, si dhe ka ndikuar në caktimin e trupës gjyqësore në një proces civil, për një çështje pronësie, për favorizimin e një pale, subjekti ka parashtruar se është një konkluzion i pabazuar në prova, por vetëm në sinjalizime dhe se subjekti në detyrën e prokurorit nuk ka asnjë kompetencë në funksionimin e gjykatave. Po kështu, subjekti, deklaroi se ashtu sikurse ka rezultuar edhe nga hetimi i Komisionit ndaj tij nuk ka ndonjë çështje penale të regjistruar. Subjekti ka referuar raste nga praktika e GJEDNj-së mbi bazueshmërinë në prova të procesit ligjor. Konkretisht, sipas subjektit, në çështjen e Unterpetinger kundër Austrisë, GJEDNj-ja shprehet se: “Pranimi i thashethemeve si prova në parim nuk është në kundërshtim me garancitë e procesit të drejtë, por, nëse nuk ka mundësi për të bërë hetime, kjo mund ta bëjë gjyqin të padrejtë, nëse dënimi bazohet tërësisht ose kryesisht në prova të tilla. Megjithatë, përdorimi si provë e deklaratave të përdoruara në fazën paragjyqësore nuk është në vetvete në kundërshtim me nenin 6, për sa kohë që të respektohen të drejtat e palës mbrojtëse.

23.4 Lidhur me konkluzionet se: “... në ngarkim të shtetasit A. L., alias P. M. (***) administrohen të dhëna të cilat ngrenë dyshime të arsyeshme për përfshirje/pjesë e krimin të organizuar... Për subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja, referuar burimeve të hapura mediatike të datës 1.11.2019, në lidhje me ngjarjen e ndodhur në zonën e Sh***, ku subjekti i rivlerësimit mbeti i plagosur nga një atentat me armë zjarri, rezultoi se ka qenë i shoqëruar në makinë me shtetasin A. L., lidhje shoqërore e z. Arian Ndoja. Ky shtetas, rezultoi të jetë person me precedent penal dhe me rrezikshmëri të lartë shoqërore. Aktualisht kjo ngjarje është në hetim nga ana e Prokurorisë së Posaçme të Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar...”, subjekti ka deklaruar se është e papercptueshme se si një organ i tillë si DSIK-ja të mbështetet në lajme mediatike. Sipas tij, citimi se ky shtetas rezultoi me precedentë penale vjen në kundërshtim të plotë me provat e administruara nga Komisioni, ku ky shtetas nuk rezultoi as i dënuar dhe as i proceduar penalisht nga asnjë institucion ligjzbatues në Republikën e Shqipërisë. Ndërkohë, që sipas tij, ashtu sikurse është parashtruar edhe nga DSIK-ja, ngjarja e vitit 2019 është në hetim nga SPAK dhe se edhe sipas përgjigjes së SPAK drejtuar Komisionit, ndaj këtij shtetasi nuk ka një procedim penal të nisur. Për këto shkaqe, sipas tij, nuk mund t’i kalojë barra e provës.

23.5 Në mbështetje të pretendimeve të tij, subjekti iu është referuar disa dispozitave ligjore, praktikave gjyqësore, jurisprudencave të Kolegjit mbi fuqinë provuese të provave, marrjen e vlerësimit të tyre, si dhe qëndrimeve të mbajtura nga Komisioni në rastet e subjekteve E. I. dhe I. T., në lidhje me periudhën e deklaratimit në deklaratën e kontrollit të figurës dhe besueshmërinë e konstatimeve të raportit të DSIK-së. Konkretisht:

i) Subjekti i është referuar nenit 32 të Kushtetutës, i cili parashikon se: “Askush nuk mund të detyrohet të dëshmojë kundër vetes apo familjes së tij, si dhe as të deklarohet fajtor në bazë të të dhënave të mbledhura në mënyrë të paligjshme”. Po kështu, sipas subjektit, neni 30 i Kushtetutës dhe neni 4 i Kodit të Procedurës Penale parashikojnë se: “Kushdo quhet i pafajshëm, përderisa nuk i është provuar fajësia me vendim të formës së prerë”. Sipas subjektit, respektimi i parimit të prezumimit të pafajësisë nga Gjykata Kushtetuese, si dhe ajo e Strasburgut, është konsideruar si element i rëndësishëm i parimit të një procesi të rregullt ligjor.

ii) Subjekti i referohet disa praktikave gjyqësore, duke deklaruar se:

- Gjykata e Lartë, në praktikën e saj gjyqësore, edhe më parë është shprehur se: “Përcaktimi i vërtetësisë së provës që është vënë si kusht nga ligjvënësi për të pasur një proces ligjor

çmuarje të saj, nënkupton verifikimin se ku konsiston lidhja e rrethanës apo objektit material konkret me objektin e të provuarit në çdo gjykim konkret”.

- Gjykata Evropiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, në vendimin e saj, datë 10.2.1995, çështja Allent de Ribemont kundër Francës, ndër të tjera, arsyeton se: “... *prezumimi i pafajësisë i parashikuar në paragrafin e 2 të nenit 6 është një ndër elementet e një procesi penal të drejtë siç kërkohet nga paragrafi 1 (shihni veçanërisht vendimin Deweer kundër Belgjikës, datë 20.2.1980). Ky parim shkelet në qoftë se një vendim gjyqësor lidhur me një person të akuzuar për kryerjen e një veprë penale pasqyron një mendim paraprak se ai është fajtor, kur fajësia e tij nuk është provuar ende në bazë të ligjit. Madje, edhe nëse nuk ka ende një konstatim formal, ka shkelje, dhe kur gjatë arsyetimit del se gjyqtari e konsideron të pandehurin fajtor”.*

- Në vendimin nr. 97, datë 20.3.2013, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë është shprehur se: “*Nga aktet dhe provat e shqyrtuara rezulton se të dy gjykatat e faktit i kanë bazuar vendimet e tyre vetëm në një provë të vetme, siç janë bisedat telefonike, të cilat, sipas vlerësimit të gjykatave të faktit, janë zhvilluar ndërmjet të gjykuarve dhe pa i analizuar ato me asnjë provë tjetër, direkte ose indirekte, që provon fajësinë e të pandehurve, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e pikës 1 të nenit 152 të Kodit të Procedurës Penale, duke i dhënë kësaj prove vlerë të paracaktuar...duke iu referuar akteve dhe provave që ndodhen në dosjen gjyqësore, por duke iu referuar sidomos arsyetimit të vendimeve të gjykatave të faktit, konstatohet se nuk ekziston asnjë provë direkte ose indirekte që të tregojë që këto biseda telefonike janë zhvilluar nga të gjykuarit, por nga këto gjykata është prezumuar, pa pasur prova, si dhe pa i analizuar ato, madje edhe pa i përmendur, se këto biseda janë zhvilluar nga të gjykuarit, duke vepruar kështu në kundërshtim me kërkesat e nenit 380 të Kodit të Procedurës Penale”.*

iii) Duke iu referuar jurisprudencës së Kolegjit, subjekti ka deklaruar se: “*Kolegji i Posaçëm i Apelit në çështjen e subjektit P. Ç. ka mbajtur qëndrimin: me këtë bazë të dhënash dhe këtë nivel aksesi mbi informacionin e klasifikuar, Kolegji, mbështetur në të drejtën e gjykatës për të vlerësuar të dhënat e klasifikuara pa cenuar të drejtat themelore të individëve dhe ato që prekin thelbin e një procesi të rregullt ligjor, në konsideratë edhe të udhëzimeve e qëndrimeve që vijnë nga jurisprudenca e GJEDNj-së, në çështjen Regner vs Czech Republic, analizoi dhe vlerësoi këto të dhëna mbi bazën e parimit të ligjshmërisë e objektivitetit.*

Në analizë të këtyre të dhënave, të nënshtruara vlerësimit të trupës gjykuese nën regjimin e informacionit të klasifikuar si sekret shtetëror, rezultoi se ato nuk sillnin informacion për kontakte të papërshtatshme të subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar sipas përcaktimeve të nenit Dh të Aneksit të Kushtetutës e neneve 34 e 39 të ligjit nr. 84/2016, por ngrinin dyshime për përfshirje të subjektit në një episod paligjshmërie në drejtim të ushtrimit të detyrës”.

iv) Subjekti i është referuar disa qëndrimeve të Komisionit si vijon:

- Në trajtimin e çështjes për subjektin e rivlerësimit E. I., Komisioni ka konkluduar se: “*Në këto kushte, në të cilat asnjë institucion në territorin e Republikës së Shqipërisë nuk disponon një të dhënë të tillë, Komisioni nuk konstatoi se ish-bashkëshorti i subjektit dhe ish-kunati kanë qenë apo janë të dënuar për vepra penale që lidhen me krimin e organizuar. Bazuar në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, Komisioni vlerëson se kontrolli i figurës nis me plotësimin e deklaratës për figurën nga subjekti, që mbulon periudhën nga 1.1.2012 deri në ditën e deklaramit. Pra, subjekti i rivlerësimit deklaroi për kontakte të papërshtatshme referuar kësaj periudhe.*

Neni 34 i ligjit nr. 84/2016 përcakton qartë objektin e kontrollit të figurës, që është verifikimi i deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin e atyre subjekteve që kanë kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, Komisioni nuk konstatoi deklaratime të pasakta të subjektit në deklaratën e figurës dhe as kontakte të papërshtatshme të saj me persona të përfshirë në veprimtari kriminale lidhur me vepra që përfshihen në krimin e organizuar”.

- Në trajtimin e çështjes për subjektin e rivlerësimit I. T., Komisioni ka konkluduar se: *“Në këtë rast, informacioni i përcjellë nga DSIK-ja nuk përmban elementet e parashikuara nga neni 38 i ligjit nr. 84/2016, prandaj ai konsiderohet i paplotë. Duke e konsideruar procesin e rivlerësimit një proces kushtetues që, megjithëse përfshin edhe kufizimin e të drejtave të subjekteve të rivlerësimit, kërkohet ta kryejë atë gjithnjë në përputhje me parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, raporti për subjektin e rivlerësimit duhet të jetë konkret, sa më i qartë, mbështetur në të dhëna të sakta, që provojnë lidhjet e subjektit të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, lidhje këto që mund ta bëjnë edhe subjektin e rivlerësimit lehtësisht të ndikueshëm prej tij. Në vijim të kësaj analize, u dërgua një shkresë pranë DSIK-së me shpjegimet dhe argumentet e thëna edhe më lart, ku kërkohet që ajo të shikojë edhe një herë raportin e saj, në frymën e ligjit dhe të Kushtetutës.*

*Po ashtu, në vijim të pikës 3 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës, të nenit 50 të ligjit nr.84/2016 dhe në vijim të vendimit Nr. 2/2017 të Gjykatës Kushtetuese, iu drejtua SHISH-it, me kërkesën për informacion të mëtejshëm lidhur me këtë rast, me qëllim garantimin e provave dhe krijimin e bindjes së brendshme, lidhur me komponentin e vlerësimit të figurës për këtë subjekt rivlerësimi. Me qëllim garantimin e një procesi të drejtë dhe kushtetues, vlerësohet si shumë i rëndësishëm administrimi i provave dhe fakteve të nevojshme për një vendimmarrje të drejtë. DSIK-ja iu përgjigj shkresës sonë në datën 10.4.2018. Në këtë shkresë, ajo sqaronte se nga verifikimi i kryer pas kërkesës sonë për rishikimin e raportit, pas verifikimit shtesë të bërë, rikonfirmon konstatimin për papërshtatshmërinë e ushtrimit të detyrës për subjektin, shkresa nr. *** prot., datë ***, sekret, shiko në dosjen e rivlerësimit, duke marrë për bazë vetëm informacionin që ajo dispononte për përfshirjen e këtij gjyqtari në veprime korruptive dhe duke vlerësuar se koncepti thelbësor përcaktues i integritetit profesional të subjektit të rivlerësimit është sistemi i vlerave që tregojnë për pastërtinë e figurës së gjithsecilit prej tyre. Duke qenë se informacioni ishte i vitit 2004, nuk kishte shumë detaje, por as nuk mund të konfirmohej se ai ishte nga burime të besueshme dhe me akses, por se ai ngrihej mbi dyshime për përfshirje të gjyqtarit (asaj kohe kryeinspektor) në veprime korruptive. Referuar informacionit shpjegues mbi terminologjinë e përdorur, “ngrihen dyshime” -përdoret kur veprimtaria del nga një e dhënë, e cila duhet të vërtetohet në vazhdimësi”.*

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me pretendimet për raportin e dytë të DSIK-së

24. Sa i takon kontrollit të figurës, në zbatim të vendimit nr. 2/2017, të Gjykatës Kushtetuese, pavarësisht konstatimeve të raportit të dytë të DSIK-së, Komisioni ka kryer një hetim të pavarur bazuar në Kreun V të ligjit nr. 84/2016, duke marrë të dhëna si nga ky raport, ashtu edhe nga çdo burim tjetër ligjor, publik ose jo publik. Në zbatim të parimit të kontradiktoritetit, për çdo situatë të dhënë dhe paqartësi të dalë gjatë hetimit administrativ, subjektit i janë kërkuar sqarime mbi konstatimet e raportit të dytë të DSIK-së, për të cilin nuk i ka kaluar barra e provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Barra e provës i ka kaluar subjektit në përfundim të analizës mbi kontrollin e figurës nga ana e Komisionit, në vlerësim të të gjitha informacioneve të administruara.

25. Për sa pretendohet nga subjekti mbi periudhën e vlerësimit të figurës, periudha që subjekti i referohet 1 janar 2012 deri në momentin e dorëzimit të deklaratës *Vetting*, lidhet me detyrimin e subjektit për deklarimin e të dhënave brenda kësaj periudhe, përcaktuar në pikën 2, të nenit DH, të Kushtetutës, i cili parashikon shprehimisht se: “*Subjektet e rivlerësimit plotësojnë dhe i dorëzojnë Komisionit një deklaratë të detajuar për figurën e tyre që mbulon periudhën nga data 1 janar 2012 deri në ditën e deklarimit, sipas ligjit*”, e në këtë kuptim, subjektit nuk i është bërë me dije ndonjë pasaktësi në deklarim. Sa i takon të dhënave të paraqitura në raportin e dytë të DSIK-së, që i përkasin periudhave kohore 2009-2010 dhe 2018-2020, këto të dhëna i janë nënshtruar një hetimi administrativ të pavarur nga Komisioni, së bashku me të dhëna të tjera të marra nga burime të ligjshme.

26. Për sa pretendohet nga subjekti, lidhur me dorëzimin e raportit të DSIK-së, tej afateve të përcaktuara në nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni verën se raporti i parë i DSIK-së mban datën 2.11.2017, ndërsa raporti i dytë ka ardhur pas kërkesës për përditësim nga ana e Komisionit dhe është i datës 1.12.2020, sikurse është vepruar për të gjitha subjektet e rivlerësimit. Nga ana tjetër, është fakt, që ngritja dhe konstituimi i organeve të rivlerësimit ka ndodhur në muajin qershor të vitit 2017, çka ka sjellë edhe administrimin me vonesë të raporteve përkatëse nga ana e organeve ndihmëse.

27. Për sa pretendohet nga subjekti në lidhje me konstatimet e DSIK-së për shtetasin A. L., është trajtuar në pjesën e vlerësimit të Komisionit lidhur me këtë shtetas (shihni paragrafin 39 të këtij vendimi).

Veprime hetimore të kryera nga Komisioni për disa persona, sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar⁵

28. Gjatë hetimit administrativ, nga ana e Komisionit, u kryen verifikime në lidhje me shtetasit A. L., *alias* A. L., *alias* P. M., *alias* L. M.; E. Sh./E. Sh.; Gj. K.; R. K.; E. V./M. V.; G. N.; D. B. P.; R. A. (ose K. A.); G. H., T. L., ku rezultoi se:

29. Në lidhje me shtetasin A. L., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Nga informacionet e publikuara në media, referohet se në momentin e atentatit datës 1.11.2019, ndaj prokurorit Arian Ndoja, ai shoqërohej edhe nga shtetasi A. L., i njohur ndryshe si L. M. apo P. M., i referuar si person me precedentë penale dhe që ka ndryshuar disa herë identitetin.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit për marrëdhënien me shtetasin A. L., P. M., A. D., D. M., subjekti ka deklaruar⁶ se në dijeninë e tij janë i njëjti person dhe se ka marrëdhënie shoqërore që zë fill nga periudha e ushtrimit të aktivitetit të avokatisë, për shkak të konsulencës ligjore të dhënë.

- Për të verifikuar identitetin e saktë të këtij shtetasi iu kërkua informacion DPGJC dhe nga të dhënat e administruara rezultoi se shtetasi A. Xh. L. ka ndryshuar disa herë gjeneralitetet e tij⁷.

- Nga verifikimet e kryera nuk u konfirmuan procedime penale apo pasurore të regjistruara për këtë shtetas, apo procedime penale të trajtuara nga subjekti për të gjitha gjeneralitetet që ka pasur ky shtetas⁸.

⁵Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 11.5.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 11.5.2021, në dosjen e Komisionit.

⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr.2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 28.5.2021, në dosjen e Komisionit.

⁷Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 28.5.2021, të DPGJC në dosjen e Komisionit, sipas të cilës shtetasi A. Xh. L. ka pasur gjeneralitetet si vijojnë: P. Xh. M., i datëlindjes 26.11.1974, P. Xh. M., i datëlindjes 26.11.1974; D. Xh. M., i datëlindjes 26.11.1974; P. Xh. M., i datëlindjes 26.11.1974; P. Xh. Y., i datëlindjes 26.11.1974; P. Xh. Y., i datëlindjes 3.8.1973; A. Xh. D., i datëlindjes 3.8.1973; si dhe A. Xh. L., i datëlindjes 3.8.1973.

- Gjatë hetimit administrativ, Komisioni është informuar se për shtetasin A. D. ka të dhëna se është përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë territorit të Shqipërisë. Sipas qëndrimit të Kolegjit, i cili i është referuar jurisprudencës së GjEDNj-së, konkretisht vendimit Regner kundër Republikës Çeke, sipas të cilit: “...gjykatat kanë autoritetin për të kryer një shqyrtim të hollësishëm të arsyeve të mbështetura nga autoriteti për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara. Ato mund të vlerësojnë arsyet e dhëna për moszbulimin e dokumenteve të klasifikuara dhe dhënien e informacioneve shpjeguese atyre që konsiderojnë se nuk e garantojnë atë klasifikim”, nga ana e Komisionit është vlerësuar mosekspozimi i burimit të informacionit të klasifikuar⁹.

- Nga verifikimi i të dhënave të hyrje-daljeve të sistemit *TIMS*, nuk rezultuan të dhëna për udhëtime të subjektit me të gjithë shtetasit me identitetet e evidentuara nga Zyra e Gjendjes Civile. Ndërkohë që për shtetasin A. Xh. L., referohen të dhëna se në vitin 2011 dhe 2012 është proceduar penalisht në gjendje të lirë për shkak të një aksidenti rrugor. Pas administrimit të këtyre dosjeve nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁰ rezultoi se ky shtetas është proceduar në vitin 2011 dhe 2012 përkatësisht për veprat penale “shkatërrim i pronës”, parashikuar nga neni 150 i Kodit Penal dhe “kanosje”, parashikuar nga neni 84 i Kodit Penal, si dhe “shkelje e rregullave të qarkullimit rrugor”, parashikuar nga neni 290/1 i Kodit Penal, për të cilat është vendosur në të dyja rastet mosfillimi i procedimit penal nga prokurorët E. Xh. dhe S. N.

- Nga aktet procedurale të administruara nga SPAK¹¹ rezulton se shtetasit Arian Ndoja dhe A.L. (P. M.) njihen me njëri-tjetrin dhe konfirmohet se para sulmit të datës 1.11.2019, të dy kanë qenë duke drekuar me z. E. Sh. dhe një person tjetër. Po kështu, është informuar se shtetasi A. L. (ose P. M.) ditën e ngjarjes së datës 1.11.2019, ndodhej në të njëjtin automjet me subjektin dhe ishte ulur në sediljen e pasme.

30. Në lidhje me shtetasin L. M., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Subjekti pranoi se ka thjesht njohje me këtë shtetas, si djali i xhaxhait të shtetasit P. M., por nuk ka pasur kontakte telefonike apo takime me të¹².
- Ndaj këtij shtetasi nuk rezultuan procedime penale apo pasurore për veprimtari të krimit të organizuar¹³.
- Nga të dhënat e sistemit *TIMS* referohet se ndaj tij në datën 27.6.2011 ka filluar procedimi penal në gjendje të lirë dhe në vitin 2016 është shpallur në kërkim.
- Ndaj këtij shtetasi¹⁴ është regjistruar materiali hetimor nr. ***, për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga prokurorja E. Xh.

⁸Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 4.10.2021, nga SPAK; shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.9.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme; shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2021 dhe kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

⁹Shihni vendimin nr. 7, datë 24.6.2020, të KPA-së.

¹⁰Shihni dosjet e dy procedimeve penale bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit

¹¹Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.9.2021, nga SPAK drejtuar vëzhguesit ndërkombëtar, bashkëngjitur opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar me nr. *** prot., datë 22.10.2021.

¹²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 28.0.2021, në dosjen e Komisionit.

¹³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

¹⁴Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dokumentacioni bashkëngjitur në dosjen e Komisionit

31. Në lidhje me shtetasin E. Sh./Sh., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Nga verifikimi i të dhënave të hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*, rezultoi se ky shtetas ka gjeneralitetet E. Z. Sh., i datëlindjes 29.1.1968, gjithashtu, në lidhje me këtë shtetas, referohen të dhëna për disa procedime penale në periudhën 2010 – 2014, si dhe në vitin 2019. Ky shtetas ka udhëtuar me subjektin: (i) me automjetin me targa ***, dalje më 22.08.2015, hyrje më 23. 8.2015; (ii) me automjetin me targa ***, dalje më 27.1.2013, hyrje më 27.1.2013.
- Nga aktet procedurale të administruara nga ana e SPAK¹⁵, subjekti Arian Ndoja dhe persona të tjerë kanë qenë duke drekuar para sulmit me z. E. Sh.
- I pyetur nga Komisioni, subjekti ka mohuar një marrëdhënie të afërt shoqërore me këtë shtetas, duke deklaruar¹⁶ se ky shtetas është ndërtues, jeton në Durrës dhe me të ka njohje nga puna, duke qenë se ka pasur vite që ushtronte detyrën në atë qytet.
- SPAK nuk konfirmoi procedime penale apo pasurore në emër të këtij shtetasi¹⁷.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, me shkresën nr. *** prot., datë 1.6.2021, ka dhënë informacion mbi disa procedime penale të regjistruara dhe të trajtuara në këtë prokurori për shtetasin E. Z. Sh¹⁸.
- Në vijim, pas kërkesës së Komisionit, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës¹⁹ paraqiti dokumente, sipas të cilave ndaj shtetasit E. Sh. ka pasur: (i) kallëzime penale për veprat penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a, “pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal, “vjedhje nëpërmjet mashtrimit”, parashikuar nga neni 143 i Kodit Penal, si dhe “dhunim banese”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal, për të cilat është vendosur mosfillimi i procedimit penal nga prokurorët B. B., T. Rr., A. Sh., G. V., K. B. dhe S. N.; (ii) tri kërkesa për gjykimin e tij për veprat penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, “mospagim i taksave dhe tatimeve”, parashikuar nga neni 181 i Kodit Penal, të prokurorëve A. J. dhe A. Sh.; (iii) një procedim penal nr. ***, për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, regjistruar në datën 6.10.2020, i trajtuar nga prokurori Arian Ndoja, i cili është bashkuar me procedimin nr. ***, po për veprën penale “ndërtimi i paligjshëm” dhe ndjeka e hetimeve të mëtejshme i është ngarkuar prokurorit A. Sh.; (iv) në lidhje me objektin në pronësi të shtetasit E. Z. Sh., është hetuar procedimi penal nr. ***, për të cilin subjekti Arian Ndoja ka vendosur pushimin e procedimit penal në datën 9.5.2019.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë²⁰ ka informuar se ndaj shtetasit E. Sh. është regjistruar procedimi penal nr. ***, për veprën penale “kanosje për deklarim e dëshmi, ekspertim apo përkthim të rremë në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 312/a dhe 25 të Kodit Penal, që është dërguar për gjykim në datën 24.6.2020.
- Gjatë hetimit administrativ, u evidentua se emri i shtetasit E. Sh., është përmendur edhe në aktet e dosjes së procedimit penal të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda, të regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal nr. ***²¹ ndaj prokurorit

¹⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 21.9.2021, nga SPAK, drejtuar vëzhguesit ndërkombëtar, bashkëngjitur opinionit të IMO me nr. *** prot., datë 22.10.2021.

¹⁶Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 28.0.2021, në dosjen e Komisionit.

¹⁷Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

¹⁸Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.9.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

¹⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dokumentacioni bashkëngjitur, si dhe shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në dosjen e Komisionit.

²⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.9.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

²¹Shihni aktet e procedimit penal përcjellë nga SPAK me shkresën nr. *** prot., datë 3.6.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

Arian Ndoja, për korrupsion aktiv, ku kallëzuesi L. P., në cilësinë e drejtorit të ASHK-së Durrës ka pretenduar se prokurori Arian Ndoja i ka bërë presion me qëllim që të legalizojë një objekt shumëkatësh që i përket shtetasit E. Sh./Sh. Nga aktet e kësaj dosje, del e qartë se bëhet fjalë për shtetasin E. Z. Sh., i datëlindjes 29.1.1968, vendlindja Sh***, i cili ka qenë i dënuar në vitin 2012 nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës për veprat penale “mospagim i taksave dhe tatimeve” si dhe “falsifikimi i dokumenteve», ndërkohë që është vendosur pushimi i çështjes penale për verat penale “ndërtimi i paligjshëm” dhe “falsifikimi i vulave, stampave apo i formularëve”.

32. Në lidhje me vëllezërit/shtetasit V. K., B. K. dhe A. K., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Nga të dhënat e sistemit *TIMS*, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka udhëtuar, ndër të tjerash, edhe me automjetin me targa ***, në vitin 2013. Nga verifikimi në sistemin e AMF-së, ky automjet rezultoi në pronësi të shtetasit V. K., i datëlindjes 25.5.1970 (ka dhe ditëlindjen 30.5.1978) dhe përdorues vëllai i tij, B. K., i datëlindjes 22.3.1975.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit, subjekti ka deklaruar²² se automjeti me targa **** është në pronësi të shtetasit B. K., duke deklaruar se është njohje e tij që në vitin 2005, me të cilin ka lidhje dhe shoqëri familjare.

- SPAK nuk konfirmoi procedime penale apo pasurore në emër të shtetasit B. K.²³.

- Nga informacioni i marrë nga Prokuroria e Përgjithshme²⁴, referuar të dhënave të dërguara nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lezhës, rezulton se për shtetasin B. P. K. janë regjistruar procedimet penale si vijojnë: procedimi penal nr. *** në ngarkim të tij, për veprat penale të parashikuara në nenet 186 dhe 172 të Kodit Penal, dërguar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me kërkesën për gjykim të datës 28.6.2013 dhe procedimi nr. ***, i pushuar.

- Sa i takon shtetasit V. K., nga informacionet e publikuara në media, rezultojnë të dhëna për një shtetas me këtë emër, i dënuar në Itali për vrasje dhe trafik armësh.

- Nga të dhënat në sistemin *TIMS*, rezultoi se shtetasi me gjeneralitete V. P. K., i datëlindjes 30.5.1978, ka udhëtuar disa here me dy automjete me targa *** dhe ***, të cilat janë në pronësi të subjektit Arian Ndoja, në vitet 2011 dhe 2013. Ndërkohë, që në datën 25.11.2011 ky shtetas ka dalë jashtë shtetit së bashku me subjektin e rivlerësimit nga pika kufitare e ***.

-SPAK nuk konfirmoi procedime penale apo pasurore në emër të shtetasit V. K.²⁵.

- Në lidhje me vëllezërit K., referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar²⁶, nga dosja e procedimit penal nr. ***, ka rezultuar se:

i) Pas një kallëzimi në lidhje me shtetasit A. K., B. K. dhe V. K. në datën 28.9.2017, është regjistruar procedimi penal për veprën penale “pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal, pa emër personi të regjistruar në regjistrin e veprave penale, nga prokurori E. Sh.²⁷.

²²Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 28.5.2021, në dosjen e Komisionit.

²³Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 4.10.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

²⁴Shihni dosjen bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.10.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme në dosjen e Komisionit.

²⁵Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr.*** prot., datë 22.12.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

²⁶Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 15.12.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 16.12.2021, në dosjen e Komisionit.

²⁷Ky prokuror ka kërkuar dy herë pushimin e çështjes, ndërkohë që Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, me vendimet në vitet 2018 dhe 2019, ka vendosur dy herë kthimin e akteve për vazhdimin e hetimeve. Ndërkohë, me vendimin nr. ***, datë 11.2.2021, kjo gjykatë ka vendosur pushimin e çështjes penale, që i përket procedimit penal me nr.***. Në informacionin

ii) Shtetasi A. K. (vëllai i B. dhe V. K.) është dënuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, për veprën penale të “vrasje me paramendim” dhe “armëmbajtje pa leje”, parashikuar nga nenet 78/1 dhe 278/2 të Kodit Penal, kryer në shtetin Italian²⁸. Gjatë hetimit administrativ, Komisioni administroi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë²⁹, vendimin nr. ***, datë 17.10.2008, i cili konfirmon faktin e dënimit të shtetasit A. K. për veprat e mësipërme.

- Nga verifikimi i sistemit *TIMS*, në lidhje me shtetasin A. P. K., nuk u gjet informacion për udhëtime të subjektit me këtë shtetas.

- Në datën 28.8.2020 është regjistruar materiali në ngarkim të shtetasit A. P. K. dhe në lidhje me këtë material, pas kërkesës me vendimin nr. ***, datë 1.2.2021, nga Gjykata e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar është vendosur sekuestrimi i pasurive të shtetasit A. P. K. dhe personave të lidhur me këtë subjekt, E. K., B. K. dhe P. K.³⁰.

33. Në lidhje me shtetasin D. B./P., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Nga verifikimi i të dhënave të hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*, ky shtetas ka gjeneralitetet D. A. B./P., i datëlindjes 18.9.1983, vendlindja Sh***, Durrës. Po kështu, rezulton që subjekti të ketë përdorur shumë herë nga viti 2014 – 2018, automjetet me targa *** dhe ***, të cilat sipas sistemit AMF-së janë në pronësi të shtetasit D. B./P. Ndërkohë që për këtë shtetas referohet se është proceduar në gjendje të lirë dy herë në vitin 2012 dhe një herë në vitin 2010.

- I pyetur gjatë procesit të rivlerësimit për marrëdhënien me këtë shtetas subjekti ka deklaruar³¹ se ka njohje për shkak të shërbimeve që ofron në servisën e makinave “****”, ndodhur në autostradën Durrës-Tiranë. Më tej, ka deklaruar se dy automjetet e mësipërme kanë qenë në pronësi të shtetasit D. B. P. dhe bëhet fjalë për të njëjtin mjet.

- SPAK nuk konfirmoi procedime penale apo pasurore në emër të këtij shtetasi³².

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³³ nuk ka konfirmuar materiale hetimore apo procedime penale të trajtuara nga subjekti për këtë shtetas.

- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³⁴ konfirmoi se ndaj shtetasit D. B. P. është regjistruar: (i) procedimi penal nr. ***, për veprën penale të “plagosjes së lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal, trajtuar nga prokurori G. H., për të cilin është vendosur pushimi i procedimit penal; (ii) procedimi penal nr. *** për veprën penale “trafikimi i mjeteve motorike”, parashikuar nga neni 141/a i Kodit Penal, i cili është transferuar në vitin 2015 në Prokurorinë e Rrethit Shkodër; (iii) procedimi penal nr.***, për veprën penale “falsifikimi dhe përdorimi i dokumenteve dhe formularëve të falsifikuar”, parashikuar nga neni 186/1 dhe 190/1 të Kodit Penal, trajtuar nga prokurori F. E., vepër për të cilën ky shtetas është deklaruar fajtor duke u dënuar me gjobë nga gjykata.

34. Në lidhje me shtetasit R. K. dhe Gj. K., nuk rezultuan të dhëna.

për referimin e veprës të prokurorit të hartuar nga OPGj, është sugjeruar regjistrimi i tyre në regjistrin e veprave penale, por nuk është marrë parasysh nga prokurori.

²⁸http://images.processopenaleegiustizia.it/f/sentenze/documento_5xn5X_ppg.pdf

²⁹Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.1.2022, nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lezhë, në dosjen e Komisionit.

³⁰Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 22.12.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

³¹Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 28.5.2021, në dosjen e Komisionit.

³²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021, nga SPAK në dosjen e Komisionit.

³³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2021, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.

³⁴Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dokumentacioni bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

35. Në lidhje me shtetasin E. V./M. V., u administruan të dhënat si vijojnë:

- Nga verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile të vitit 2008, rezultoi se shtetasi E. V. ka gjeneralitetet M. K. V., i datëlindjes 15.9.1976.
- Në përgjigje të pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se shtetasi E. V. është një shok shkolle i gjimnazit në Krujë, me të cilin ka marrëdhënie të mira familjare.
- Nga verifikimi i të dhënave të hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*, rezultojnë se shtetasi M. K. V. ka udhëtuar disa herë më subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja, me automjetet me targat ***, *** (të dyja në pronësi të shtetasit D. B. P.), *** (në pronësi të subjektit) dhe automjetin me targa ***, përkatësisht në vitet 2013, 2015 dhe 2017.
- SPAK nuk konfirmoi procedime penale apo pasurore në emër të këtij shtetasi³⁵.
- Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës³⁶ nuk ka konfirmuar materiale hetimore apo procedime penale të trajtuara nga subjekti për këtë shtetas.
- Në lidhje me shtetasin E. V. rezultojnë³⁷ materiali procedural nr. ***, datë 7.4.2014, për veprën penale “pushtim i tokës”, për të cilin me vendimin e datës 2.6.2014, prokurorja P. P. ka vendosur mosfillimin e procedimit penal³⁸, si dhe procedimi penal nr. ***, datë 3.6.2019, dërguar gjykatës me kërkesë për pushim për veprën penale “shpërdorim i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal dhe dërgim në gjyq për veprën penale “ndotje e ajrit”, parashikuar nga neni 201 i Kodit Penal.
- Në artikullin e publikuar në datën 23.7.2018, në *linkun*: <http://www.panorama.com.al/rrahja-e-avokatit-babai-i-te-kerkuarit-ndoja-shtyu-dhe-pagoi-djalin-tim-per-te-dhunuar-ilian/>, si dhe në disa media të tjera të tjera³⁹, rezultojnë se shtetasi K. V., babai i shtetasit M. V., i shpallur në kërkim si autor i dhunës ndaj avokatit I. I., në Durrës, ngre akuza të rënda ndaj prokurorit Arian Ndoja, duke e denoncuar për vjedhje e korrupsion, pasi ka përvetësuar pasurinë e familjes së tij. Sipas këtij artikulli, ai i ka kërkuar ndjesë publike avokatit, duke deklaruar se djali i tij, M. V., është shtyrë dhe paguar nga prokurori Arian Ndoja për të dhunuar avokatin I. I., duke konfirmuar faktin se djali i tij ka qenë shok shkolle me prokurorin dhe ky i fundit e ka përdorur atë për të bërë punë të pista. Në këtë artikull shtetasi K. V. pretendon se prokurori Arian Ndoja ia ka marrë gjithë pasurinë, ndër të tjerash, edhe lokalin që kishin familjarisht, i cili sot ndodhet në hipotekë në emër të familjes Ndoja.
- Me qëllim verifikimin e këtyre informacioneve, me sugjerimin e vëzhguesit ndërkombëtar të ONM-së, Komisioni kërkoi të pyesë në cilësinë e dëshmitarit shtetasit I. I. dhe K. V., nga të cilët u paraqit vetëm avokati I. I.⁴⁰.

³⁵Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.6.2021 dhe nr. *** prot., datë 4.10.2021, nga SPAK, në dosjen e Komisionit.

³⁶Shihni shkresat kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 26.5.2021 dhe nr. *** prot., datë 13.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

³⁷Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 13.09.2021, nga Prokuroria e Përgjithshme dhe bashkëngjitur saj shkresën nr. *** prot., datë 9.6.2021, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Krujë, në dosjen e Komisionit.

³⁸Shihni dosjen e procedimit penal bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Krujë, në dosjen e Komisionit

³⁹[Marrë nga Dosja.al](#)

[Marrë nga shqiptarja.com](#)

[Marrë nga oranews.tv](#)

<https://lapsi.al/2018/07/21/babai-i-autorit-qe-dhunoi-avokatin-jam-ankuar-dhe-tek-ambasada-eshba-per-prokurorin/>

⁴⁰Shtetasi K. V., është njoftuar nëpërmjet Drejtorisë së Policisë së Fushë Krujës, me shkresën e datës 12.20.2021, por nuk u paraqit pranë Komisionit, për t'u pyetur në cilësinë e dëshmitarit.

- Në deklaratimet e tij⁴¹ para Komisionit, shtetasi I. I. konfirmoi faktin se ishte konfliktuar verbalisht me subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja gjatë një seance gjyqësore, ku ky prokuror përfaqësonte organin e akuzës dhe se ishte kërcënuar prej këtij të fundit. Më tej, deklaroi se të nesërmen e seancës ishte goditur nga dy njerëz që qëndronin pranë prokurorit Arian Ndoja, një nga të cilët edhe shtetasi M. V. Po kështu, shtetasi I. I. deklaroi se shtetasi me të cilin subjekti shihet në foton e publikuar në *linkun* https://shqiptarja.com/lajm/ekskluzive-report-tv-siguron-videon-e-dhunimit-te-avokatit-i-***-i-***-dhunuesit-jane-dy-persona, është shtetasi M. V., i cili kishte qenë një nga personat që e kishte goditur.

- Sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar dosjes së procedimit penal nr. ***⁴², rezulton se në ngarkim të shtetasit M. V. në datë 19.7.2018 është regjistruar një procedim penal për veprën penale “kundërshtimi dhe goditja e gjyqtarit e kryer në bashkëpunim”, e parashikuar nga nenet 316-25 të Kodit Penal. Ky procedim është regjistruar mbi bazën e kallëzimit penal të bërë nga avokati I. I., i cili ka pretenduar se është goditur nga shtetasi M.V., për shkak të detyrës, për shkak të një konflikti që av. I. I. ka pasur me një prokuror të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës. Nga aktet e kësaj dosjeje ka rezultuar se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 18.06.2021, ka vendosur: deklarinin fajtor të të pandehurit M. V. për kryerjen e veprës penale “*plagosje e lehtë me dashje*” kryer në bashkëpunim parashikuar nga nenet 89 dhe 25 të Kodit Penal dhe dënimin e tij me 6 muaj burgim. Në aplikim të nenit 63 të Kodit Penal, është pezulluar ekzekutimi i vendimit me burgim dhe zëvendësimi i tij me detyrimin e të pandehurit M. V., për të kryer 100 orë punë në interes publik.

36. Në lidhje me shtetasit F. C. dhe G. N., nuk rezultuan të dhëna.

37. Me sugjerim të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti është pyetur mbi qëndrimin e tij në lidhje me disa artikuj të publikuar në media dhe që kanë lidhje me: (i) gjetjen e disa dosjeve të Prokurorisë së Rrethit Durrës në makinën prokurorit Arian Ndoja pas atentatit, ku pretendohet se këto dosje i përkasin firmës ligjore të prokurorit⁴³; (ii) lidhjen e prokurorit me persona me precedentë penalë⁴⁴. Në lidhje me këto shkrime, në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar se duke mos qenë funksionar i zgjedhur por i emëruar, si dhe, bazuar në formimin e tij profesional, nuk mund të japë opinione apo mbajë qëndrime emocionale në lidhje me këto shkrime.

Barra e provës kaluar subjektit në lidhje me kontrollin e figurës

38. Në përfundim të hetimit administrativ në lidhje me kriterin e vlerësimit të figurës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të japë sqarime dhe dokumente shkresore në lidhje me: (i) kontaktet me shtetasin A. L. (D.) për të cilin ka të dhëna që është i

⁴¹Shihni procesverbalin e pyetjes së shtetasit I. I., të datës 14.10.2021, në dosjen e Komisionit.

⁴²Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 15.11.2021 dhe fashikullin bashkëlidhur, në dosjen e Komisionit

⁴³Shihni: *Marrë nga shqiptarja.com*

<https://dritare.net/Arian-ndoj-flet-per-dosjet-e-gjetura-ne-makine-pas-atentatit>

Marrë nga gazetatema.al

⁴⁴Shihni:<https://dosja.al/portreti-i-paautorizuar-i-Arian-ndojes-magjistrati-i-shkelqyer-qe-rrinte-me-kriminele-atentati-ne-durres-dhe-dy-versionet-e-prokurorise-e-policise/>

<https://www.balkanweb.com/nga-mbrojtja-e-trafikanit-te-fotoja-me-dhunuesin-e-avokatit-kush-eshte-prokurori-ndoja-qe-akuzohet-per-lidhje-me-bandat/>

https://360grade.al/120625/rrahja-e-avokatit-babai-i-te-kerkuarit-ndoja-shtyu-dhe-pagoi-djalin-tim-per-te-dhunuar-i-***/

<https://indeksonline.net/plumbat-sishin-per-mua-zbardhet-deshmia-e-prokurorit-Arian-ndoja/>

Marrë nga forumshqiptar.com

https://lajmifundit.al/2019/11/02/b-***-prokurori-i-plagosur-Arian-ndoja-duhet-te-arrestohet/

<https://gazetaimpakt.com/ekskluzive-misteri-gruas-avokate-te-prokurorit-arian-ndoja-i-dhuruan-196-mije-m2-toke-ne-durres/>

Marrë nga top-channel.tv

përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar dhe mosdeklarimin e këtij fakti në deklaratën për kontrollin e figurës, sipas shtojcës 3, të ligjit nr. 84/2016; (ii) kontaktet me disa persona të proceduar penalisht, për shkak të të cilave mund të vihet nën presion, sipas parashikimit të germës “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit

Në parashtrimet e tij të datës 26.4.2022, subjekti ka parashtruar në mënyrë të përmbledhur se:

39. Në lidhje me shtetasin A. L. (D.), subjekti ka deklaruar se ky person nuk rezulton as i dënuar dhe as i proceduar penalisht nga asnjë institucion ligjzbatues në Republikën e Shqipërisë. Sipas tij, ndaj këtij personi nuk ekziston asnjë masë ndalimi qoftë në territorin shqiptar ashtu edhe në vendet e Bashkimit Europian dhe ky fakt vërtetohet lehtësisht edhe nga lëvizja e lirë e këtij personi në pikat kufitare. Po kështu, duke iu referuar ngjarjes së vitit 2019, në të cilën edhe shtetasi A. L. ishte lënduar, ngjarje e cila është nën hetim nga SPAK, subjekti pretendon se nuk mund t'i kalohet barra e provës për plotësim të pasaktë të deklaratës për pastërtinë e figurës, e cila sipas Kushtetutës përfshin periudhën janar i vitit 2012 deri në ditën e dorëzimit të kësaj deklarate që është në janar të vitit 2017. Në lidhje me këtë shtetas, subjekti ka paraqitur certifikatë elektronike printuar në datën 11.4.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilës, pas verifikimit të regjistrit gjyqësor, shtetasi A. Xh. L. është *i padënuar*.

Në parashtrimet e tij, në lidhje me informacionin konfidencial, sipas së cilit për shtetasin A.L., ka të dhëna që është i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë shtetit, subjekti ka deklaruar vetëm se ndaj këtij personi nuk ekziston asnjë masë ndalimi në vendet e Bashkimit Europian, duke iu referuar faktit se ai lëviz lirisht në pikat kufitare. Ndërsa, i pyetur në seancën dëgjimore nëse kishte ndërmarrë ndonjë veprim për të verifikuar nëse ky shtetas ka qenë i përfshirë në veprimtari kriminale jashtë shtetit, subjekti duke konfirmuar faktin që ky shtetas ka qenë me të në makinë ditën e ngjarjes, deklaroi se me këtë shtetas nuk kishte një njohje aq të afërt dhe se nuk mbante kontakte prej 1 viti e 11 muaj. Gjithashtu, subjekti në seancën dëgjimore deklaroi se ishte i gatshëm që, nëse i lihej një afati i arsyeshëm, të kërkonte të dhëna nga INTERPOL-i, në lidhje me këtë shtetas.

40. Në lidhje me kontaktet me persona të proceduar penalisht, subjekti ka parashtruar se përcaktimet e nenit 37 të ligjit nr. 84/2016, i referohen veprave penale që lidhen me krimin e organizuar dhe se gjatë hetimit administrativ është provuar se ndaj të gjithë këtyre personave nuk rezulton asnjë procedim penal. Subjekti ka paraqitur certifikatat elektronike printuar në datën 11.4.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, për shtetasit V. K., B.K., M. V., D. B. P. dhe E. Sh.

Përveç shtetasit A. L., për të cilin ka deklaruar se nuk është person i përfshirë në krimin e organizuar (trajtuar më sipër), për secilin prej shtetasve që Komisioni kishte kryer hetime, subjekti ka parashtruar si vijon:

40.1. Për shtetasin E. Sh., subjekti ka deklaruar se ka një vendim të Gjykatës së Apelit Durrës, nr. ***, datë 8.6.2015, sipas të cilit është deklaruar i pafajshëm në lidhje me akuzën “mospagim i taksave dhe tatimeve”. Ndërsa, me vendimin nr. ***, datë 15.12.2016, Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *mospranim rekursi të paraqitur nga Prokuroria pranë Gjykatës së Apelit Durrës*. Gjithashtu, sipas subjektit, me vendimin nr. ***, datë 23.6.2016, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, të gjyqtarit T. H., ky shtetas është deklaruar i pafajshëm për veprën penale “dhunim në banesë”, parashikuar nga neni 112 i Kodit Penal, vendim, i cili, pasi është shqyrtuar nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin nr.***, datë 3.4.2017, ka vendosur: “Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes.” Ndërkohë, subjekti ka paraqitur certifikatën elektronike printuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor

Durrës, datë 11.04.2022, sipas së cilës shtetasi E. Sh. është i dënuar. Gjithashtu, i pyetur në seancë dëgjimore⁴⁵, nëse në konceptin e tij një person me gjendje gjyqësore “i dënuar” konsiderohet ose jo me precedent penal, subjekti konfirmoi se ky është koncepti ligjor edhe sipas tij.

40.2 Për shtetasit me mbiemër K., subjekti ka parashtruar se B. K. dhe V. K. nuk janë të dënuar në vendin tonë për ndonjë nga veprat penale të parashikuara në nenin 75/a të Kodit të Procedurës Penale, si dhe në asnjë nga format e parashikuara të bashkëpunimit sipas neneve 25,28, 333 e vijues të Kodit Penal. Ndërsa në lidhje me shtetasin A. K., subjekti ka deklaruar se pavarësisht faktit që ka njohje me dy vëllezërit e tij, nuk ka pasur dhe as ka ndonjë kontakt rastësor apo jo rastësor me këtë shtetas. Referuar të dhënave të sistemit *TIMS*, ky shtetas nuk ka qenë në territorin e Shqipërisë që nga viti 2001 dhe se nuk e ka takuar asnjëherë personalisht, ndërkohë që njohjen me familjarët e tij e ka në një kohë më të vonshme. Sipas subjektit, ky fakt është konfirmuar edhe nga ana e Komisionit, pasi nuk janë gjetur të dhëna që të konfirmojnë kontaktet e subjektit me këtë person.

Në lidhje me shtetasit B. K. dhe V. K., subjekti ka paraqitur vendimin nr. ***, datë 11.02.2021, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lezhë, sipas të cilit është vendosur pushimi i procedimit penal për veprën penale “pastrim i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”. Gjithashtu, subjekti ka paraqitur certifikatat elektronike printuar në datën 11.4.2022, nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, sipas të cilave shtetasit V. K., B. K. janë të padënuar.

40.3. Për shtetasin D. P., subjekti ka deklaruar se rezulton i padënuar dhe proceduar penalisht. Sa i takon procedimit penal të vitit 2002, për të cilin ky shtetas është dënuar, sipas subjektit, është e qartë se ky dënim është 10 vjet përpara periudhës së deklaramit në janar të vitit 2012. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur dijeni në lidhje me një fakt të tillë dhe as ka ndihmuar apo kontribuar në asnjë fazë të kësaj procedure gjyqësore. Ky shtetas sipas tij, ka një servis makinash ku ka kryer shërbime për automjetet e tij dhe njohja me të është e këtij karakteri, duke nënkuptuar mungesën e një marrëdhënieje të afërt.

40.4. Për shtetasin M. V., subjekti ka konfirmuar marrëdhënien e tij të miqësisë që nga fëmijëria. Në lidhje me procedimin penal të vitit 2018 në ngarkim të këtij shtetasi, ku ai është deklaruar fajtor nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, subjekti ka informuar se ky vendim nuk është i formës së prerë dhe se ndaj këtij vendimi është depozituar ankimi pranë Gjykatës së Apelit Durrës. Për më tepër, sipas tij, kjo çështje është regjistruar në vitin 2018, pas dorëzimit të deklaratës për pastërtinë e figurës dhe referuar praktikës së mbajtur nga Komisioni këto rezultate nuk duhet të merren parasysh në frymën e interpretimit të nenit DH të Aneksit të Kushtetutës.

Vlerësimi i Komisionit në lidhje me kontrollin e figurës, bazuar në prova e fakte dhe në ligjin e zbatueshëm

41. Sa i takon kontrollit të figurës së subjekteve të rivlerësimit, si një nga kriteret mbi të cilat mbështeten organet e rivlerësimit, sipas parashikimit të pikës 1, të nenit 4, të ligjit nr.84/2016, ky ligj, në kapitullin VII të tij, ka sanksionuar dispozitat ligjore të cilat

⁴⁵Shihni procesverbalin e zbardhur të seancës dëgjimore.

parashikojnë proceduat ligjore për kontrollin e figurës, duke përcaktuar DSIK-në si organin kompetent që kryen këtë kontroll në bashkëpunim me organe të tjera ligjzbatuese, sipas parashikimit të neneve 37, 38 dhe 39, të ligjit nr. 84/2016, si dhe nenit DH të Aneksit të Kushtetutës. Sipas këtyre dispozitave ligjore, pastërtia e figurës së subjekteve të rivlerësimit ka lidhje me: (i) plotësimin me saktësi të formularit të deklarimit për kontrollin e figurës nga ana e subjekteve të rivlerësimit; si dhe me (ii) kontakte të subjekteve të rivlerësimit me persona të përfshirë në krimin e organizuar.

42. Në lidhje me kontaktin me shtetasin A. L. dhe plotësimin e formularit të deklarimit për kontrollin e figurës nga ana e subjektit të rivlerësimit, gjatë hetimit administrativ, u vërtetua se subjekti ka kontakte me shtetasin A. L., për të cilin ka pasur të dhëna konfidenciale, sipas të cilave ka qenë i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, informacion për të cilin referuar çështjes Regner kundër Republikës Çeke, sikurse është parashtruar në rezultatet e hetimit dërguar subjektit, Komisioni nuk ka ekspozuar burimin e informacionit.

Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016: *“Person i përfshirë në krimin e organizuar” është çdo person që është dënuar ose proceduar penalisht, brenda ose jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, për një nga veprat e parashikuara në pikën 1, të nenit 3, të ligjit nr. 10 192, datë 3.12.2009, “Për parandalimin dhe goditjen e krimit të organizuar, trafikimit dhe korrupsionit nëpërmjet masave parandaluese kundër pasurisë”, të ndryshuar, me përjashtim të rastit kur është deklaruar i pafajshëm me vendim gjyqësor të formës së prerë. Personi konsiderohet i përfshirë në krimin e organizuar edhe kur: (a) procedimi penal i filluar ndaj tij pushohet nga organi procedues për shkak të vdekjes, ose sepse nuk mund të merret si i pandehur dhe nuk mund të dënohet; (b) deklarohet i pafajshëm nga gjykata pasi vepra penale është kryer nga një person, që nuk mund të akuzohet ose dënohet”.*

Referuar kësaj dispozite ligjore, në kushtet e mungesës së të dhënave të plota nëse shtetasi A.L., ndodhet në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore të sipërpërmendur, Komisioni nuk mund të arrijë në konkluzionin, nëse ky shtetas i përmbush kriteret ligjore për t’u konsideruar person i përfshire në krimin e organizuar. Në këto kushte, nuk mund të konkludohet se subjekti ka kontakte të papërshtatshme me këtë shtetas në kuptim të nenit 38 të ligjit nr. 84/2016, dhe, për rrjedhojë, nuk mund arrihet në konkluzionin se ka plotësuar në mënyre të pasaktë formularin e deklarimit të figurës.

43. Në lidhje me kontaktet me persona me precedent penal, neni 37 i ligjit nr. 84/2014, në germën “c” të tij, parashikon vlerësimin e përgjithshëm nëse individ/subjekti, mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, i cili mund të përbëjë shkak për të arritur në përfundimin për papërshtatshmërinë e tij për ushtrimin e detyrës, ashtu sikurse DSIK-ja kishte konkluduar. Në kushtet kur asnjë nga shtetasit me të cilët u vërtetuan kontakte dhe marrëdhënie me subjektin e rivlerësimit, nuk u vërtetua të jenë përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar, sipas përkufizimit të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016, në përfundim të procesit, Komisioni nuk mund të vlerësojë se subjekti mund të vihet nën presion nga struktura kriminale, në kuptim të germës “c”, të nenit 37, të ligjit nr. 84/2016.

Vlerësim përfundimtar në lidhje me rivlerësimin e figurës

44. Në vlerësimin përfundimtar të kriterit kontrollit të figurës, Komisioni iu referua nenit 51 të ligjit nr. 84/2016, sipas së cilit: *“Në rast se subjekti i rivlerësimit nuk paraqet provat, sipas nenit 85 të KPA, si dhe kur provat që disponojnë janë të paplota, Komisioni ose KPA, mund të vendosin bazuar në provat që disponojnë, në vlerësimin e çështjes në tërësi, si dhe në*

bindjen e tyre të brendshme". Në konsideratë të kësaj dispozite ligjore, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se bazuar në të gjitha provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në një vlerësim tërësor të rrethanave të rezultuara gjatë këtij procesi, arsyetuar hollësisht në këtë vendim, subjekti rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë, referuar fakteve dhe rrethanave si vijojnë:

i) Për shtetasin A. L., me të cilin subjekti ka pasur kontakte, ka të dhëna që ka qenë i përfshirë në veprimtari të krimit të organizuar jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë, ndërkohë që subjekti nuk ka bërë përpjekje dhe nuk ka paraqitur asnjë provë për të vërtetuar të kundërtën e këtij informacioni. Në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se informacioni i klasifikuar i verifikuar prej tij dhe vëzhguesit ndërkombëtar është i besueshëm, por duke mbajtur në konsideratë vlerësimin e GJEDNj-së në vendimin Regner kundër Republikës Ceke, ka çmuar se ekspozimi i tij do të passillte edhe ekspozimin e burimeve të informacionit të klasifikuar.

ii) Në lidhje me shtetasit e tjerë me të cilët u vërtetuan kontakte dhe marrëdhënie të ngushta të subjektit të rivlerësimit, në mënyre të përmbledhur, rezultoi se:

- Ndonëse shtetasi M. V. figuron i padënuar është fakt që në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës janë trajtuar disa çështje, në lidhje me këtë shtetas, ku është vendosur mosfillimi i procedimit penal, pushimi i tij, apo në një rast tjetër çështja është dërguar për gjykim dhe Gjykata Rrethit Gjyqësor Durrës e ka dënuar për kryerjen e veprës penale "plagosje e lehtë me dashje". Sipas subjektit, ky vendim nuk është i formës së prerë, pasi shtetasi M. V. ka bërë ankim, fakt të cilin nuk e vërtetoi me ndonjë dokument shkresor. Gjithashtu, shoqërimi i subjektit nga ky shtetas në një seancë gjyqësore, ku ai përfaqësonte organin e akuzës, si dhe kërcënimet dhe goditja e avokatit të çështjes në shqyrtim, z. I. I., nga ana e shtetasit M. V., menjëherë pas përfundimit të seancës, së bashku me faktet e sipërpërmendura hedhin dritë mbi mungesën e etikës së prokurorit dhe çmohen si rrethana që cenojnë besimin e subjektit në publik.

- Shtetasi E. Sh. rezulton me precedent penal. Po kështu, për këtë shtetas në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës janë trajtuar disa çështje, për të cilat, sipas rastit, është vendosur mosfillimi i procedimit penal apo janë dërguar për gjykim. Për më tepër, subjekti është në kushtet e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës me këtë shtetas, pasi ka trajtuar dy procedime penale që lidhen me të.

- Shtetasi D. B./P. është person i dënuar në vitin 2002, për veprën penale "falsifikim dhe përdorim të dokumenteve dhe formularëve të falsifikuar". Po kështu, për këtë shtetas, në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës janë trajtuar disa çështje, për të cilat, sipas rastit, është vendosur mosfillimi i procedimit penal apo transferimi i çështjes në një prokurori tjetër.

- Ndonëse nuk u vërtetuan marrëdhënie të subjektit me shtetasin A. K., person i dënuar në Itali, u vërtetuan kontakte të subjektit me vëllezërit e tij B. dhe V. K., në lidhje me të cilët, në datë 28.9.2017, është regjistruar procedimi penal për veprën penale "*pastrim të produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale*", i pushuar nga gjykata, ndërkohë që në vitin 2021 gjykata ka vendosur sekuestrimin e pasurive të personave të lidhur me shtetasin A. K., ndër të cilët edhe për B. K. Për më tepër, në vendimin e datës 3.2.2009, të prokurorit B. C. "Për pushimin e procedimit penal nr. ***, nisur në bazë të denoncimit të ILDKPKI-së ndaj subjektit Arian Ndoja, për refuzim deklarimi, konfirmohet se B. K. është marrë në pyetje dhe deklaroi se e ka paguar Ndojën, në cilësinë e avokatit mbrojtës, për shërbimet e ofruara për vëllain e tij dhe persona të tjerë të akuzuar për vepra penale, në Itali.

Veç sa më sipër, pretendimi i subjektit në lidhje me periudhën/periudhat e procedimeve apo dënimeve penale të shtetasve me të cilët u vërtetuan kontakte, në disa raste edhe nga

Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës, ku subjekti ka ushtruar detyrën, nuk e lehtësojnë pozitën e subjektit, i cili duhet të shmangte kontaktet me ta, sidomos gjatë kohës që ka qenë duke ushtruar detyrën e prokurorit.

Bazuar në sa më sipër, në përfundim të procesit, Komisioni çmoi se subjekti ndodhet në kushtet e nenit 61/5 të ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon rastet e marrjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjekteve të rivlerësimit.

Mbi vlerësimin profesional

45. Në zbatim të nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja, bazuar në: (i) raportin me nr. *** prot., datë 25.10.2021, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. **** prot., datë 3.11.2021; (ii) informacionin e marrë nga burime të ligjshme; (iii) kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

46. Raporti për analizimin e aftësive profesionale i kryer nga Këshilli i Lartë Prokurorisë është bazuar në analizën e: (i) formularit të vetëdeklarimit, si dhe të dhënave të dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit; (iii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iv) të dhënave nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme dhe prokurorive të rretheve gjyqësore.

Në përfundim, Këshilli i Lartë i Prokurorisë, bazuar në kriteret ligjore të parashikuara në ligjin nr. 96/2016 ka vlerësuar subjektin e rivlerësimit Arian Ndoja si vijon:

Për aftësitë profesionale

a) Njohuritë ligjore

Prokurori Arian Ndoja shfaq aftësi në drejtim të zbatimit të ligjit. E ka të qartë drejtimin e hetimit që do të kryejë në rastin konkret. Menjëherë, pasi urdhëron regjistrimin e procedimit, subjekti i rivlerësimit përcakton detyrat me shkrim për oficerin e policisë gjyqësore, duke i përshkruar konkretisht se çfarë duhet të kryejë dhe duke i vendosur afatin e kryerjes së tyre. Ai identifikon saktë normën ligjore të zbatueshme.

b) Arsyetimi ligjor

Subjekti shfaq aftësi në arsyetim ligjor. Tregon vëmendje që aktet e përgatitura prej tij të paraqiten të strukturuar me një gjuhë të kuptueshme. Tek aktet e përgatitura nga subjekti i rivlerësimit konstatohet se nga ana e tij bëhet analizë mbi rrethanat e faktit dhe provave të mbledhura, duke shprehur qëndrimin e tij logjik mbi zgjidhjen ligjore.

Për aftësitë organizative

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Prokurori Arian Ndoja, në periudhën e rivlerësimit, ka trajtuar gjithsej 519 materiale. Ai ka kryer detyrat e tij në pajtim me pikën 2 dhe 2.1 të urdhrit nr. ***, datë 9.5.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve në prokuroritë e shkallës së parë”. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale, prokurori, subjekt rivlerësimi, ka përballuar ngarkesën e punës. Konkretisht, është evidentuar kohëzgjatja e trajtimit të praktikave që i korrespondon dosjeve të shortuara, ku nuk kanë rezultuar problematika.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Subjekti i rivlerësimit, prokurori Arian Ndoja, merr pjesë në gjykim, si palë, duke përfaqësuar Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës. Konstatohet se tregon profesionalizëm në gjykim dhe qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Dosjet janë të administruara rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe disponimin e gjykatës.

Për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale

a) Etika në punë

Gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit.

b) Integriteti

Nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Arian Ndoja. Nuk ka të dhëna mbi ndonjë shkak paanësie të dokumentuar. Asnjë prej dokumenteve të vëzhguara nuk lidhet me çështje të grupeve në nevojë, të barazisë gjinore apo të pakicave. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit.

Për aftësitë personale dhe angazhimi profesional

a) Aftësitë e komunikimit

Komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Nuk rezultojnë të dhëna konkrete që flasin mbi aftësinë e subjektit për të bashkëpunuar mes kolegësh apo më gjerë.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti Arian Ndoja rezulton se ka marrë pjesë në një sërë trajnimesh me temë në fushën penale, të organizuar pranë dhe jashtë programit të Shkollës së Magjistraturës, të cilat janë përshkruar më sipër.

Informacion i marrë nga burime të ligjshme, verifikuar si vijon:

47. Tri vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan, përgjithësisht, të njëjtat gjetje të konstatuara edhe nga KLP-ja në raportin e saj.

48. Sa i takon dosjes nr. 4, të përzgjedhur me short, lidhur me procedimin penal nr. *** të regjistruar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, datë 6.3.2014, për veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, që i përket shtetasit A. Z., për të cilin subjekti Arian Ndoja, në datën 28.4.2014, ka vendosur pushimin e procedimit penal pranë Komisionit dhe është paraqitur një opinion nga vëzhguesi ndërkombëtar⁴⁶ ku është konstatuar se:

⁴⁶Shihni opinionin e vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 12.11.2021, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 12.12.2021, në dosjen e Komisionit.

- në momentin e arrestimit, shtetasit A. Z. iu sekuestruan 10 gram pluhur me përmbajtje të elementëve paracetamol dhe kafeinë, substanca të cilat edhe pse nuk përfshihen në tabelat e substancave narkotike dhe psikotrope, njihen gjerësisht si zbutës të efektit të heroinës⁴⁷;

- vendimi për pushimin e procedimit penal, i datës 28.4.2014, është bazuar kryesisht në rezultatin e ekspertizës mjeko-ligjore të trupit të të dyshuarit që kanë treguar praninë e substancave të tilla si kafeina dhe paracetamoli, të cilat edhe duke qenë të paligjshme në vetvete, subjekti i rivlerësimit vendosi të mbyllë çështjen.

49. Në përfundim të hetimit administrativ, në konkluzion të analizës së çështjes sipas opinionit të ONM-së, duket se subjekti ka treguar mangësi profesionale pasi: (i) duke mbajtur në konsideratë se paracetamoli dhe kafeina japin një rezultat fals të heroinës duke zbutur efektin e saj, vërehet se nga subjekti i rivlerësimit nuk janë ndërmarrë hapa të mëtejshëm hetimorë dhe nuk janë kryer veprime të plota hetimore për të zbuluar nëse i dyshuari kishte kryer veprën penale “prodhim dhe shitje e narkotikëve”, parashikuar nga neni 283 i Kodit Penal, i vetëm ose në bashkëpunim; (ii) subjekti nuk ka bërë përpjekje për të përcaktuar nëse i dyshuari kishte konsumuar elementët e parashikuar në nenin 285 të Kodit Penal, në lidhje me veprën penale “mbajtje, prodhim dhe transportim i substancave kimike”, sepse të përziesh heroinën me kafeinë dhe paracetamol “çon në prodhimin e substancave psikotropike”, pra, një drogë që del eventualisht nga përzierja e tyre.

50. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kërkua të japë sqarime e paraqesë dokumente në lidhje me konstatimet e mësipërme. Në parashtrimet e tij subjekti ka parashtruar se:

Së pari, konkluzioni i tij lidhur me këtë çështje është bazuar në mendimin e ekspertëve A. K. (B.) dhe L. H., eksperte të Drejtorisë së Policisë Shkencore Tiranë, të cilët kanë njohuri të posaçme dhe arrijnë me metoda shkencore dhe ekzaminime laboratorike që të përcaktojnë se çfarë përbërje kishte lëndë e sekuestruar, e dyshuar si lëndë narkotike. Ato kanë paraqitur aktekspertimin nr. ***, datë 16.4.2014, akt i gjendur në faqet 26 dhe 27 të fashikullit të procedimit penal nr. ***, në konkluzion të secilit thuhet shprehimisht se:

“1. Analiza cilësore GC/MS për pluhurin objekt ekspertimi tregoi për praninë e paracetamolit dhe kafeinës. 2. Paracetomoli dhe kafeina nuk gjenden në tabelat e lëndëve narkotike dhe psikotrope. 3. Referencat për klasifikimin në lëndë narkotike ose jo gjenden në ligjin nr. 7975, të datës 26.7.1995, ‘Për barnat narkotike dhe lëndët psikotrope’”.

Së dyti, sipas subjektit, referuar logjikës juridike dhe shkrimeve të doktrinës së të drejtës penale kudo në botë, duhet që për raste kur një person kapet me kokainë, prokurori të regjistrojë procedimin penal për veprën penale “prodhim dhe shitje të narkotikëve”, “trafikim të lëndëve narkotike”, “kultivim të bimëve narkotike”, etj., vepra të parashikuara në nenin 283 e vijues të Kodit Penal, pasi dihet që kokaina kërkon bimët e mbjella, të cilat përpunohen më pas dhe kthehen në lëndë narkotike, të cilat nuk mbillen në vendin tonë dhe nuk kultivohen këtu, por jashtë vendit, që trafikohen deri sa mbërrijnë këtu dhe në fund përfundojnë në duart e atij që kapet. Ai deklaroi se në asnjë rast nuk ka hasur që për lëndë kimike ose substanca që janë në shitje të lirë nëpër farmaci, të cilat nuk janë të përziera me asnjë lloj lëndë të ndaluar të klasifikuar si lëndë narkotike, të regjistrohet procedim penal për veprën penale të parashikuar nga neni 285 i Kodit Penal. Subjekti ka paraqitur dosjen e procedimit penal nr. ***.

⁴⁷Shihni artikullin e disponueshëm në <https://www.europeview.org/wp/wp-content/uploads/4461-4466> dhe titulluar si "Komentari - Pastërtia e heroinës dhe përzierja: një realitet i përditësuar nga Sistemi Italian i Paralajmërimit", ku thuhet se "në mënyrë interesante del se kafeina ishte përzierësi më i zakonshëm (55 % raste), i ndjekur nga methorfani (52.3 % raste) dhe paracetamoli (36.9%, raste) (...)]."

51. Në analizë të pretendimeve të subjektit vlerësohet se konkluzioni i arritur prej tij në vendimin e tij përputhet me aktekspertimin nr. ***, datë 16.4.2014, të ndodhur në dosjen e procedimit penal. Ndërsa, sa i takon konstatimit për mungesën e përpjekjeve për të përcaktuar nëse ka pasur elementë të veprës penale të parashikuar në nenin 285 të Kodit Penal, në përfundim të procesit vlerësohet se ngritja e akuzës dhe kualifikimi juridik i veprës penale është një tagër ekskluzive e organit të akuzës, që i përket bindjes së brendshme të prokurorit, e që mund të jenë objekt i shqyrtimit gjyqësor dhe, si të tilla, dalin jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

52. Nga të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme, rezultoi se:

- Në vitin 2004 subjekti është shkarkuar nga detyra me Dekret të Presidentit të Republikës dhe është rikthyer përsëri me Dekret të Presidentit në vitin 2008.

- Pas kërkesës së Komisionit mbi praktikën e rikthimit në detyrë të subjektit, KLP-ja⁴⁸ vuri në dispozicion Dekretin Nr. ***, datë 28.1.2008, të Presidentit të Republikës për emërim prokurori dhe vendimin nr. ***, datë 1.6.2006, të Gjykatës së Lartë, nga të cilat rezultojnë se subjekti Arian Ndoja është rikthyer në detyrë me Dekret të Presidentit të Republikës pas vendimit të Gjykatës së Lartë.

- Në vitin 2008 subjekti është pezulluar nga detyra.

- Pas kërkesës së Komisionit, KLP-ja⁴⁹ vuri në dispozicion akte të praktikës së pezullimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi se: (i) me urdhrin nr. ***, datë 25.11.2008, të Prokurorit të Përgjithshëm është urdhëruar pezullimi nga detyra si Drejtues i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, deri në përfundim të procedimit penal nr. *** të regjistruar në ngarkim të z. Arian Ndoja, në datën 20.11.2008; (ii) me vendimin për pushimin e procedimit penal të datës 3.2.2009, Prokuroria e Rrethit Tiranë (prokurori B. C.) ka vendosur pushimin e hetimeve të procedimit penal nr. ***, të vitit 2008; (iii) kundër vendimit të pushimit, ILDKPKI-ja ka paraqitur ankim në Prokurorinë e Përgjithshme; (iv) në memon drejtuar Prokurores së Përgjithshme të datës 26.2.2009, Drejtuesi i Drejtorisë së Inspektimit, z. A. D., ka dhënë opinionin sipas të cilit vendimi i marrë nga prokurori i çështjes është i bazuar dhe nuk ka vend për të ndërhyrë për prishjen e këtij vendimi.

Pra, siç vërehet nga Prokurori i Përgjithshëm, në datën 25.11.2008 është vendosur pezullimi i subjektit si drejtues i prokurorisë deri në përfundim të procedimit penal në ngarkim të tij, por nuk ka ndonjë akt të posaçëm të Prokurorit të Përgjithshëm për rikthimin e tij në detyrë duke lënë të paqartë datën e saktë të rikthimit të subjektit në detyrë. Ndërkohë është konstatuar se në funksion të hetimit të procedimit penal nr. *** (trajtuar më poshtë) nga subjekti Arian Ndoja, si prokuror i çështjes janë kryer veprime hetimore në janar të vitit 2009, pra në periudhën kur ka qenë i pezulluar.

53. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjekti i është kërkuar të japë sqarime mbi: (i) datën e rikthimit të tij në detyrë, pas urdhrit nr. ***, datë 25.11.2008, “Për pezullimin nga detyra si Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, duke paraqitur dokumente për të vërtetuar këtë fakt; (ii) kryerjen e veprimeve hetimore prej tij si prokuror gjatë periudhës së pezullimit.

54. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se ka një dallim thelbësor mes aktit administrativ “Pezullim nga detyra” si drejtues dhe aktit administrativ “Pezullim nga detyra” si prokuror, dhe se pasojat juridike të këtyre akteve janë të ndryshme dhe nuk mund të

⁴⁸Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 8.11.2021, nga KLP-ja dhe dokumentacioni bashkëngjitur, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹Shihni shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.1.2022, dhe dokumentacioni shoqëruar nga KLP-ja në dosjen e Komisionit.

identifikohen si një e vetme. Në rastin konkret, sipas tij, nuk ekziston një akt administrativ me përmbajtje pezullim nga detyra si prokuror në emrin e tij (neni 26 i ligjit nr. 8737/2001). Më tej, subjekti ka sqaruar se pezullimi nga detyra si Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës, do të thotë që nuk mund të ushtronte kompetencat si drejtues institucioni deri në daljen e një akti tjetër administrativ të Prokurorit të Përgjithshëm që shfuqizonte aktin e parë, por kjo sipas tij, nuk do të thotë që ligjërisht nuk mund të ushtronte funksionet si prokuror.

55. Në analizë të pretendimeve të subjektit, ligji nr. 8737, datë 12.2.2002 “Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 26, përcakton se: “1. Prokurori mund të pezullohet në ushtrimin e detyrës me urdhër të Prokurorit të Përgjithshëm në këto raste: (a) kur ndaj tij vendoset nisja e procedimit penal deri në përfundimin e procedimit; (b) kur zbulohet një shkelje e rëndë disiplinore, derisa të plotësohet procedura e kërkuar për përgjegjësinë disiplinore, por jo më tepër se 30 ditë; (c) kur Prokurori i Përgjithshëm i propozon Presidentit të Republikës shkarkimin e prokurorit nga detyra.

2. Në rastin e pezullimit sipas pikës 1 të këtij neni, përkatësisht, kur prokurori nuk gjendet fajtor nga gjykata ose nuk ka kryer shkelje disiplinore ose ka kaluar afati prej 30 ditësh, i parashikuar në germën ‘b’, të pikës 1, të këtij neni, ka të drejtë të kthehet në detyrën e mëparshme.

3. Pezullimi i parashikuar në germën ‘c’, të pikës 1, të këtij neni mbaron pas shqyrtimit nga Presidenti i Republikës të propozimit të Prokurorit të Përgjithshëm”.

Nga përmbajtja e kësaj dispozite ligjore, përkundër sa pretendohet nga subjekti se ekziston një dallim mes aktit “Pezullim nga detyra si drejtues” dhe aktit “Pezullim nga detyra si prokuror”, vërehet se ligji nuk e parashikon një ndarje të tillë, pasi shprehet qartë për pezullim nga funksioni i prokurorit. Në këto kushte, pavarësisht se urdhri nr. ***, datë 25.11.2008, “Për pezullimin nga detyra të prokurorit” i Prokurorit të Përgjithshëm urdhëron shprehimisht pezullimin e subjektit nga detyra si Drejtues në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës deri në përfundimin e procedimit penal, ky urdhër nuk legjitimon vijimin e ushtrimit të funksionit të prokurorit nga subjekti gjatë periudhës së pezullimit, pasi kjo do të ishte në kundërshtim me parashikimin në germën “a”, të pikës 1, të nenit 26, të ligjit nr. 8737, datë 12.2.2001. Për më tepër, urdhri i Prokurorit të Përgjithshëm për pezullim, ka ardhur për shkak të një procedimi penal që ka lidhje drejtpërsëdrejti me subjektin e rivlerësimit dhe të regjistruar në ngarkim të tij në datën 20.11.2008. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit, Komisioni vlerësoi se subjekti nuk duhet të kryente veprime hetimore në funksion të procedimit penal nr. ***, që lidhet me shtetasin T. L., duke vepruar kështu në kundërshtim me ligjin. Kjo problematikë është mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes dhe në raport me fakte të tjera të konstatuara gjatë procesit të rivlerësimit, si një element që cenon etikën profesionale dhe besimin e publikut.

56. Në adresë të subjektit janë depozituar 8 (tetë) denoncime nga publiku, për dy prej të cilave është vlerësuar që subjektit t’i kërkohen sqarime dhe dokumente me njoftimin e rezultateve të hetimit si vijon:

57. Në denoncimin e tij shtetasi Ç. K.⁵⁰ denoncon prokurorin Arian Ndoja, duke pretenduar se ai nuk i ka dhënë informacion mbi hetimet e kryera dhe zgjatjen e afateve procedurale të çështjes së tij dhe, për këtë arsye, duhet t’i jepet masë disiplinore. Nga analiza e dokumenteve bashkëngjitur denoncimit konstatohet se:

⁵⁰Shihni denoncimin nga shtetasi Ç. K., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 4.12.2018, në dosjen e Komisionit.

- Me vendimin e datës 10.10.2017 prokurori Arian Ndoja ka vendosur mosfillimin e procedimit penal për kallëzimin penal nr. ***, viti 2017, për veprën penale “pushtim të tokës” dhe “ndërtim të paligjshëm”, parashikuar nga nenet 200 dhe 199/a të Kodit Penal.
- Me shkresën nr. *** prot., datë 16.10.2017, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i është njoftuar shtetasit Ç. K. vendimi për mosfillimin e procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, viti 2017.
- Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, me vendimin nr. ***, datë 20.11.2017, ka vendosur anulimin e vendimit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor, të datës 10.10.2017, “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. ***, i vitit 2017, të bërë nga ankuesi Ç. K., duke kërkuar kryerjen e disa veprimeve verifikuese shtesë.
- Me kërkesat e datave 8.8.2018 dhe 2.10.2018, denoncuesi Ç. K. i ka kërkuar prokurorit Arian Ndoja, përkatësisht, vënien në dispozicion të dosjes penale për kallëzimin penal nr.***, viti 2017, si dhe kopje të shkresave që konfirmojnë momentin e njoftimit të vendimit nr. ***, datë 20.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve.
- Me kërkesën e datës 26.10.2018, denoncuesi Ç. K. ka paraqitur një ankim pranë Drejtueses së Prokurorisë Durrës, znj. A. J., lidhur me mosvënien në dispozicion të shkresave që konfirmojnë momentin e njoftimit të vendimit nr. ***, datë 20.11.2017, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, si dhe vendimet e prokurorit për zgjatjen e hetimeve.
- Me shkresën e datës 29.10.2018, drejtuar avokatit K. I., Drejtuesja e Prokurorisë, znj. A. J., ka udhëzuar që kërkesat apo memoriet në bazë të nenit 110 të Kodit të Procedurës Penale duhet t’i drejtohen prokurorit të çështjes.

58. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime mbi pretendimet e denoncuesit, duke vërtetuar të kundërtën e tyre me dokumente nga dosja penale: (i) të gjitha veprimet hetimore të kryera prej tij si prokuror i çështjes; (ii) të paraqesë të gjitha vendimet për zgjatjen e hetimeve; (iii) të paraqesë të gjitha njoftimet e vendimeve të zgjatjes së afatit të hetimeve shtetasit Ç. K. me konfirmimet përkatëse, si dhe çdo vendim tjetër të marrë prej tij.

58.1. Në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur në mënyrë kronologjike ecurinë e vendimeve gjyqësore të dhëna për këtë kallëzim, si vijojnë:

- Vendimi i parë me nr. ***, datë 20.11.2017, i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes të cilit është vendosur: Anulimi i vendimit datë 10.10.2017 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës “Për mosfillimin e procedimit penal” për kallëzimin penal nr. ***, i vitit 2017, i bërë nga ankuesi Ç. K.
- Vendimi i dytë me nr. ***, datë 25.2.2020, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes të cilit është vendosur: Prishja e vendimit të datës 7.6.2019, të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës “Për pushimin e çështjes penale nr. ***, viti 2018, në ngarkim të shtetasit D. M. për veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “pushtim i tokës”, që parashikohen nga nenet 199/a dhe 200 të Kodit Penal.
- Vendimi i tretë me nr. ***, datë 31.3.2021, i dhënë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, përmes të cilit është vendosur pranimi i kërkesës së organit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës të datës 3.3.2021 dhe pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018, i regjistruar për veprat penale “ndërtim i paligjshëm” dhe “pushtim i tokës”. Ky vendim ka marrë formë të prerë me datën 20.4.2021, pasi nuk ka pasur ankim nga z. Ç. K.

Sipas subjektit, edhe pse është regjistruar procedimi penal në bazë të urdhrit të gjykatës, përsëri në fund është vendosur ashtu sikurse ai ka vendosur në vendimin e parë. Sa i takon veprimeve të kryera prej tij, ai ka deklaruar se këto veprime deri në zëvendësimin e tij si prokuror i çështjes, duken qartë në rezultatin përfundimtar të gjykatës dhe gjenden të pasqyruara në vendimin e fundit të saj. Ndërkohë, deklaroi se në këndvështrimin e tij, fotokopjimi i gjithë dosjes hetimore do të ishte i padobishëm. Ndërsa në seancën dëgjimore deklaroi se kjo ka qenë dhe objektivisht e pamundur për shkak se çështja ndiqet nga një prokuror tjetër. Gjithashtu, subjekti në seancë dëgjimore ka pretenduar se Komisioni pa të drejtë i ka kërkuar të dhëna në lidhje me mosfillimin e çështjes penale, pasi sipas tij, në rastin e mosfillimit të procedimit penal nuk kryhet hetim. Sipas subjektit, mosfillimi i këtij procedimi penal është ankuar në gjykatë, e cila ka vendosur prishjen e këtij vendimi.

Siç vërehet, deklarimet e subjektit u fokusuan më së shumti në pretendimin se në rastin e mosfillimit të procedimit penal nuk kryhet hetim, duke mos dhënë sqarime mbi kryerjen e veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata pas prishjes së vendimit të tij për mosfillimin e procedimit penal.

59. Pavarësisht pretendimeve të subjektit, nga përmbajtja e tri vendimeve gjyqësore të paraqitura nga subjekti që i përkasin kësaj çështjeje, konstatohet se: (i) fillimisht vendimi i mosfillimit të procedimit penal të subjektit Arian Ndoja i datës 10.10.2017, është anuluar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës me vendimin nr. ***, datë 20.11.2017, e cila ka urdhëruar kryerjen e disa veprimeve hetimore; (ii) pas regjistrimit të procedimit penal në datën 6.7.2018 nga Prokuroria e Rrethit Durrës për veprat penale “pushtim i tokës” dhe “ndërtim i paligjshëm” dhe kryerjes së veprimeve hetimore të lëna si detyrë nga gjykata në vendimin e saj, si dhe marrjes si të pandehur të shtetasit D. M. vetëm për veprën penale “pushtim i tokës”, organi i prokurorisë në datën 7.6.2019 ka vendosur pushimin e çështjes penale (nga përmbajtja e vendimeve nuk mund të përcaktohet se cili është prokurori që ka regjistruar procedimin penal dhe ka kryer veprimet hetimore të lëna si detyrë nga gjykata); (iii) në shqyrtimin gjyqësor të radhës, organi i akuzës është përfaqësuar në gjykim nga prokurori D.P. dhe jo subjekti i rivlerësimit; (iv) me vendimin nr. ***, datë 25.2.2020, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka anuluar vendimin e datës 7.6.2019 të prokurorisë, duke urdhëruar kryerjen e veprimeve të tjera hetimore; (v) në datën 3.3.2021, organi i prokurorisë, përfaqësuar nga prokurori D. P., ka kërkuar pushimin e procedimit penal nr. ***, viti 2018; (vi) me vendimin nr. ***, datë 31.3.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës vendosi pranimin e kërkesës së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës për pushimin e procedimit penal.

60. Siç vërehet, rezultoi të jenë kryer veprime hetimore të lëna si detyrë nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës edhe pse nuk evidentohet nëse janë kryer ose jo nga subjekti i rivlerësimit apo ndonjë prokuror tjetër i Prokurorisë së Rrethit Durrës, duke qenë se shqyrtimi gjyqësor ka vijuar nga prokurori D. P. Ndërkohë, Komisioni vlerëson se subjekti duhet dhe kishte mundësinë të vinte në dispozicion të Komisionit dokumentet që vërtetonin veprimet e kryera prej tij, të lëna si detyrë nga gjykata ashtu sikurse edhe vendimet për zgjatjen e afatit të hetimeve apo njoftimet e tyre, me qëllim të hidhte poshtë pretendimet e ngritura nga denoncuesi. Sikurse evidentohet, nga momenti i regjistrimit të procedimit penal të datës 6.7.2018 (pas vendimit të gjykatës) dhe deri në kërkesën për pushimin e çështjes në datën 7.6.2019, është një periudhë rreth 11-mujore, gjatë së cilës logjikisht duhet të jenë kryer veprime hetimore. Megjithatë, në përfundim të vlerësimit në lidhje me këtë çështje, Komisioni nuk i vlerësoi mosveprimet e subjektit si elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit, duke i mbajtur ato në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes.

61. Në dy denoncime të depozituara nga shtetasja N. U.⁵¹ ngrihen pretendime për moskryerje hetimesh dhe vendime të padrejta të prokurorit Arian Ndoja duke pushuar çështjen që i përket vajzës së saj. Me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime në lidhje me pretendimet e denoncueses, duke vërtetuar të kundërtën e tyre me dokumente nga dosja penale për të gjitha veprimet hetimore të kryera prej tij, duke paraqitur vendimet për zgjatje të afatit të hetimeve dhe çdo vendim tjetër të marrë prej tij lidhur me këtë çështje.

62. Në parashtrimet e tij në lidhje me këtë denoncim, subjekti ka deklaruar se nga verifikimi i kryer prej tij në sistemin e të dhënave pranë institucionit të prokurorisë nuk ka pasur asnjë çështje në hetim në lidhje me këtë shtetase. Ai ka informuar se nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës, nëpërmjet shkresës me nr. *** prot., datë 22.4.2022, i janë vënë në dispozicion kopje të dy vendimeve si vijojnë:

- vendimi nr. ***, datë 5.6.2014, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, i gjyqtarit T. H., ku rezulton se shtetasja N. U. është deklaruar fajtores për veprën penale “fyerje”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal, në dëm të të dëmtuarës E. M. dhe është dënuar me vlerën 50.000 lekë gjobë;

- vendimi nr. ***, datë 19.1.2016, i gjyqtarit R. B., ku kjo shtetase është deklaruar fajtores për veprën penale “fyerje”, parashikuar nga neni 119 i Kodit Penal është dënuar me vlerë 50.000 lekë gjobë.

Më tej, subjekti ka deklaruar se ka marrë pjesë në këto dy çështje përpara gjykatës, të nisura me kërkesën e të dëmtuarit akuzues, procedurë që përjashton hetimin paraprak nga ana jonë si organ procedues, bazuar në nenin 59 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Subjekti paraqiti në seancë dëgjimore shkresën me nr. *** prot., datë 22.4.2022, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës.

63. Nga përmbajtja e dy vendimeve të paraqitura nga subjekti, konstatohet se prokurori Arian Ndoja ka marrë pjesë në gjykimin e dy çështjeve me palë: e dëmtuar akuzuese E. M. dhe e akuzuar N. U. Sa i takon pretendimit se procedura e nisur me kërkesën e të dëmtuarit akuzues përjashton hetimin paraprak nga organi procedues qëndron, pasi referuar nenit 59 të Kodit të Procedurës Penale, i dëmtuari akuzues ka të drejtë të paraqesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit, ndërkohë që prokurori merr pjesë në gjykimin e këtyre çështjeve dhe, sipas rastit, kërkon dënimin e të pandehurit ose pafajësinë e tij. Në këto kushte, në përfundim të vlerësimit në lidhje me këtë çështje, Komisioni nuk gjeti elemente që cenojnë aftësitë profesionale të subjektit.

Informacioni i marrë nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁵² në lidhje me dy procedime penale të trajtuara nga subjekti i rivlerësimit si vijojnë:

64. Në lidhje me shtetasin E. Z. Sh. është regjistruar materiali hetimor nr. ***, datë 21.5.2021, i cili i ka kaluar me short elektronik subjektit Arian Ndoja dhe ky material është në verifikim. Pas kërkesës së Komisionit mbi prokurorin që e ka çështjen në trajtim dhe fazën aktuale të hetimeve, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës⁵³ informoi se pas informacionit të paraqitur nga prokurori i çështjes Arian Ndoja, ai është zëvendësuar me prokurorin A. Sh. me vendim për bashkim procedimi penal të datës 21.6.2021 dhe ndiqet nga ky i fundit. Kjo prokurori ka vendosur në dispozicion të Komisionit vendimin për bashkimin e procedimeve penale të datës 21.6.2021 të Drejtueses së Prokurorisë Durrës, znj. A. J. Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se janë bashkuar procedimi penal nr. *** për veprën

⁵¹Shihni denoncimin nga shtetasja N. U., protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 28.5.2018 dhe denoncimin e protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 18.6.2018 në dosjen e Komisionit.

⁵²Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

⁵³Shihni shkresën kthim përgjigje nr. *** prot., datë 7.10.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës dhe dokumentacioni bashkëngjitur në dosjen e Komisionit.

penale “ndërtim i paligjshëm”, parashikuar nga neni 199/a i Kodit Penal, për trajtimin e të cilit është caktuar me short prokurori Arian Ndoja, me procedimin penal nr. ***, i regjistruar në datën 6.10.2020 po për veprën penale “ndërtim të paligjshëm”, i cili ndiqet nga prokurori A. Sh. dhe se ndjekja e mëtejshme e hetimeve do të bëhet nga prokurori A. S.

64.1 Siç vërehet, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka pasur në trajtim çështjen nga data 21.5.2021 që është data e regjistrimit të materialit hetimor⁵⁴ deri në datën 21.6.2021, që është data e bashkimit të procedimeve penale. Në këto rrethana, me njoftimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkua të japë sqarime dhe të paraqesë dokumente: (i) për të vërtetuar veprimet hetimore të kryera prej tij nga data e regjistrimit të materialit kallëzues deri në bashkimin e procedimeve penale; (ii) arsyet se përse nuk e ka dhënë menjëherë dorëheqjen nga trajtimi i çështjes në kushtet kur ka pasur njohje dhe marrëdhënie me shtetasin E. Sh. (Sh.).

64.2. Në parashtrimet e tij, subjekti ka deklaruar se ka marrë pranë prokurorit A. Sh., i cili po heton procedimin penal nr. ***, të vitit 2020, një kopje të urdhrit të regjistrimit të procedimit penal, informacion drejtuar drejtueses së prokurorisë, si dhe vendimin e saj për bashkimin e procedimeve penale, duke i paraqitur edhe pranë Komisionit. Më tej, duke deklaruar se nuk ka njohje të afërta me këtë shtetas, ai ka deklaruar se nuk ka kryer asnjë veprim hetimor në këtë procedim dhe se ka qenë oficer i policisë gjyqësore që e ka vënë në dijeni për ekzistencën e një procedimi të tillë, duke theksuar se e ka si praktikë pune t'i diskutojë personalisht me OPGJ-të procedimet në lidhje me detyrat dhe ecurinë e tyre. Po kështu, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë lloj dijenie se çfarë veprimesh ka kryer më pas prokurori A. Sh., dhe se nuk i ka kërkuar asnjërit prej kolegëve të tij të mbajë ndonjë qëndrim favorizues.

Në seancë dëgjimore subjekti ka deklaruar se në fakt dorëheqjen e tij në këtë rast, e ka bërë si njoftim për heqje dorë, jo kërkesë për heqje dorë, si dhe nuk i ka shkruar nenet e ligjit për heqjen dorë, duke dashur të parandalojë çdo lakim të emrit të tij. Ndërkohë informon që në raste të tjera e ka përmendur edhe bazën ligjore të dorëheqjes, por në këtë rast nuk e ka bërë.

64.3. Në analizë të pretendimeve të subjektit, nga të gjitha dokumentet e administruara gjatë procesit lidhur me këtë çështje, ka rezultuar se: (i) kallëzimi penal ndaj shtetasit E. Sh., për ndërtim të paligjshëm, është regjistruar në sekretarinë e prokurorisë në datën 21.5.2021 dhe në regjistrin e njoftimeve të veprave penale në datën 21.5.2021; (ii) në datën 1.6.2021 subjekti Arian Ndoja ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, si dhe kryerjen e veprimeve hetimore prej vetë atij si prokuror dhe dy OPGJ A.D. dhe A. G.; (iii) në datën 18.6.2021, nëpërmjet një informacioni drejtuar drejtueses së prokurorisë Durrës, prokurori Arian Ndoja ka sugjeruar bashkimin e procedimit penal të regjistruar prej tij në datën 1.6.2021, me procedimin penal të regjistruar në datën 6.10.2020 po për veprën penale “ndërtim i paligjshëm” në ngarkim të shtetasit E. Sh. dhe vazhdimin e hetimeve nga prokurori A. Sh. për shkak se bëhet fjalë për të njëjtin fakt dhe ndaj të njëjtit shtetas; (iv) në datën 21.6.2021, Drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Durrës, znj. A. J., ka vendosur bashkimin e dy procedimeve penale në një procedim të vetëm me nr. ***, viti 2020, si dhe vazhdimin e hetimeve nga prokurori A. Sh.

64.4. Në përfundim të procesit, Komisioni çmon se në datën 1.6.2021, kur ka urdhëruar regjistrimin e procedimit penal për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”, si dhe kryerjen e veprimeve hetimore prej vetë atij si prokuror dhe dy OPGJ, A. D. dhe A. G., subjekti duhet që në zbatim të pikës 1 të nenit 26 dhe germës “ë”, të pikës 1, të nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale, të hiqte dorë nga hetimi i çështjes për shkaqe të rëndësishme

⁵⁴Nuk ka informacion se kur është hedhur shorti.

njëanshmërie me të kallëzuarin, që buron prej marrëdhënies mes tyre. Sa i takon pretendimit se me shtetasin E. Sh. nuk ka njohje të afërta, Komisioni çmon se përkundër sa pretendon subjekti, udhëtimet në dy raste të këtij shtetasi me subjektin në vitet 2013 dhe 2015, si dhe fakti që ata kanë drekuar së bashku një ditë përpara ngjarjes së nëntorit të vitit 2019, tregojnë marrëdhënie të afërta dhe në vazhdimësi të tyre.

Gjithashtu, sipas dokumentit “informacion drejtuar Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës”, A. J. me datë 18.6.2021, kur ka sugjeruar bashkimin e procedimeve dhe vazhdimin e hetimeve nga prokurori A. Sh. nuk rezulton që subjekti të ketë njoftuar drejtuesen e prokurorisë për njohjen me shtetasin E. Sh., sikurse ai deklaroi në seancë dëgjimore.

65. Në lidhje me objektin në pronësi të shtetasit E. Z. Sh. është hetuar procedimi penal nr.***, për të cilin subjekti ka vendosur pushimin e procedimit penal në datën 9.5.2019. Nga aktet e dosjes që i përkasin këtij procedimi penal⁵⁵ konstatohet se:

i) me shkresën nr. *** prot., datë 26.6.2018, Komisariati i Policisë Durrës i ka dërguar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës për vlerësim materialet e para procedurale në ngarkim të shtetasës Z. Sh.⁵⁶ për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Nga dokumentet e dërguara nga ky institucion prokurorisë, rezulton se objekti shumëkatësh objekt hetimi është në pronësi të shtetasit E. Sh. dhe ndodhet në vendin e quajtur “***”, te Sh*** K***;

ii) me urdhrin e datës 27.6.2018, subjekti Arian Ndoja ka regjistruar procedimin penal për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”;

iii) me vendimin e datës 18.2.2019, OPGJ-ja A. V. ka vendosur caktimin e ekspertit dhe kryerjen e ekspertimit, i cili është administruar në datën 8.5.2019;

iv) me vendimin e datës 9.5.2019, prokurori Arian Ndoja ka vendosur pushimin e hetimeve të çështjes penale nr. ***, të vitit 2018 për veprën penale “ndërtim i paligjshëm”. Me shkrim dore mbi këtë vendim shtetasi E. Sh. ka nënshkruar se merr përsipër njoftimin e vajzës së tij, e cila ndodhet jashtë shtetit.

66. Nga analiza e akteve të procedimit penal nr. ***, konstatohet se: (i) palë në këtë proces është shtetasja Z. Sh., vajza e shtetasit E. Sh.; (ii) hetimi i çështjes nga momenti i regjistrimit të procedimit penal e deri në pushimin e tij ka zgjatuar rreth 11 muaj; (iii) në dosje nuk ka urdhra për kryerjen e veprimeve hetimore; (iv) në kuadër të hetimit të çështjes është kryer vetëm një veprim hetimor që është kryerja e aktekspertimit teknik, i marrë pas rreth 8 muajsh nga data e regjistrimit të procedimit penal dhe nuk janë kryer veprime të tjera hetimore, si p.sh., pyetja e shtetasës Z. Sh., pyetja e pronarit të ndërtesës E. Sh., administrimi i dokumenteve të pronësisë së tij etj.

67. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar edhe opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar⁵⁷, duket se:

- subjekti ka treguar mangësi profesionale dhe organizative në trajtimin e çështjes penale në ngarkim të vajzës së shtetasit E. Sh., znj. Z. Sh.;

- subjekti ka shkelur etikën e prokurorit pasi ka trajtuar në kushtet e konfliktit të interesit një çështje penale në ngarkim të shtetasit E. Sh./Sh. dhe një çështje penale në ngarkim të vajzës së tij Z. Sh., për shkak të ekzistencës së shkaqeve të njëanshmërisë, sipas parashikimeve të neneve 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale;

⁵⁵Shihni dokumentacionin bashkëngjitur shkresës kthim përgjigje nr. *** prot., datë 26.5.2021, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶Nga verifikimi në sistemin e Gjendjes Civile, shtetasja Z. Sh. është e bija e shtetasit E. Sh.

⁵⁷Shihni opinionin me nr. *** prot., datë 21.10.2021, të vëzhguesit ndërkombëtar, në dosjen e Komisionit.

- shtetasi E. Sh./Sh. me të cilin subjekti ka njohje personale dhe kontakte, ka pasur një numër të madh çështjesh të trajtuara nga Prokuroria e Rrethit Durrës, ku subjekti ka ushtruar detyrën.

Për rrjedhojë, me mangësitë profesionale të evidentuara të ndërlidhura me konfliktin e interesit, duket se subjekti ka cenuar besimin e publikut si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të dhënë sqarime dhe paraqitur dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

68. Në parashtrimet e tij, subjekti deklaroi se në lidhje me çështjen penale ndaj shtetases Z.Sh. as nuk e ka bërë lidhjen se është vajza e shtetasit E. Sh., pasi për shkak të njohjeve jo të afërta me të e ka pasur të pamundur të njohë bashkëshorten apo fëmijët e tij dhe, gjithashtu, edhe për faktin se procedimi nuk është regjistruar me emër konkret që ai të fiksonte gjeneralitetet e saj. Më tej, subjekti ka deklaruar se vendimi është marrë bazuar në një aktekspertimi dhe nuk ka pasur vend për interpretim subjektiv të rrethanave të tjera të anës objektive si koha e ndërtimit, lloji e vendi, pra prova me dëshmitarë, por është bazuar në prova shkencore. Në parashtrimet e tij dhe në seancë dëgjimore subjekti ka deklaruar se veprimet i ka kryer të gjitha OPGj-ja, me të cilët nuk ka operuar me urdhra delegimi, pasi në praktikën e tij të punës, duke pasur marrëdhënie tepër të mira komunikative, bashkëbisedon dhe diskuton me ta. Më tej, subjekti ka deklaruar se është marrë vendim vetëm mbi bazë aktesh. Lidhur me faktin që vendimi i tij është nënshkruar nga babai i znj. Z. Sh., subjekti ka deklaruar se e ka praktikë pune njoftimin sa më shpejt të çdo personi pjesëmarrës në procedurë. Sipas tij, ai nuk gjen asnjë mangësi profesionale dhe as trajtim në konflikt interesi në asnjërin nga këto çështje. Më tej, në parashtrimet e tij, subjekti ka vazhduar me çështjen e shtetasit L. P. dhe lejen e legalizimit dhënë shtetasit E. Sh., të cilat nuk kanë qenë pjesë e barrës së provës.

Subjekti ka paraqitur disa vendime për legalizim ndërtimesh pa leje nga ASHK-ja Durrës, në favor të shtetasit E. Sh., të cilat nuk kanë lidhje me barrën e provës.

69. Në analizë të pretendimeve të subjektit, sa i takon mangësive profesionale, subjekti nuk arriti të kundërshtojë konstatimet e Komisionit të njoftuara me barrën e provës, pasi ashtu sikurse rezultoi nga hetimi administrativ, u konfirmua edhe nga subjekti që në lidhje me këtë procedim penal nuk janë kryer veprime hetimore, por vendimi është marrë vetëm mbi bazë aktesh, çka nuk e justifikon kohëzgjatjen e hetimit të çështjes për një periudhë 11-mujore nga momenti i regjistrimit të procedimit penal dhe deri në pushimin e tij.

70. Lidhur me trajtimin e çështjes nga ana e tij, në kushtet e konfliktit të interesit, pretendimet se ai nuk ka pasur dijeni që shtetasja Z. Sh. ka qenë vajza e shtetasit E. Sh., bëhen të pabesueshme referuar relatave të afërta të vërtetuara të subjektit me këtë shtetas. Për më tepër, edhe në veprimet hetimore të subjektit ndaj kësaj shtetaseje, të cilat kanë përfunduar me pushimin e hetimeve, vërehen mangësi për të cilat subjekti nuk dha shpjegime dhe të cilat dëshmojnë për njëanshmëri të tij në trajtimin e kësaj çështjeje duke anashkaluar kryerjen e veprimeve hetimore. Në këto kushte, subjekti ka shqyrtuar çështjen në ngarkim të shtetases Z.Sh., në kushtet e konfliktit të interesit në kundërshtim me pikën 1 të nenit 26 dhe germën “ë”, të pikës 1, të nenit 17, të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilave subjekti ka pasur detyrimin të heqë dorë nga hetimi i çështjes për shkaqe të rëndësishme njëanshmërie me të kallëzuarën, që burojnë prej marrëdhënies së babait të saj me subjektin. Në të njëjtat kushte, subjekti ka qenë edhe në çështjen në ngarkim të shtetasit E. Sh., trajtuar më sipër.

71. Në përfundim, Komisioni çmoi se mangësitë profesionale të evidentuara në trajtimin e çështjes në ngarkim të shtetases Z. Sh., ndërthurur me veprimet e subjektit në kushtet e

konfliktit të interesit në çështjen në ngarkim të kësaj shtetaseje dhe babait të saj E. Sh., cenojnë etikën e prokurorit dhe besimin e publikut si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë.

Informacioni i marrë⁵⁸ nga dokumenti “udhëzim” me karakter jo të detyrueshëm në çështjen penale nr. *, datë 30.9.2019, të Drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës datë 22.9.2019, sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar të datës 27.9.2020**

72. Nga përmbajtja e këtij dokumenti vërehet se nga Drejtuesja e Prokurorisë së Rrethit Durrës, znj. A. J., pas studimit të akteve të dosjes penale nr. ***, datë 22.9.2019, për veprën penale “shpërdorim detyre”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal, në ngarkim të shtetases L. K. është konstatuar se nuk janë kryer disa veprime procedurale dhe, konkretisht, ka udhëzuar: “1. Të regjistrohet emri i autorit L. P. me detyrë drejtor i Kadastrës Shtetërore Durrës; 2. Të merren dhe të administrohen akte të tjera hetimore me qëllim që të përmbushet standardi ‘i dyshimit të arsyeshëm’, me qëllim vendosjen e masës së sigurimit personal; 3. Të koordinohet puna edhe me prokurorët e tjerë, të cilët kanë nën hetim procedime penale për punonjësit e ASHK-së me qëllim administrimin e provave të tjera, si dhe mosdëmtimin e hetimeve të këtyre çështjeve të tjera nën hetim, ose bashkimin e tyre në një procedim penal; 4. Ky udhëzim nuk është i detyrueshëm për prokurorin e çështjes; 5. Nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme; 6. Në rast se prokurori vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit; 7. Udhëzimi me shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit”.

Në fund të këtij udhëzimi është shkruar me shkrim dore nga prokurori Arian Ndoja dhe nënshkruar prej tij, si vijon: “Respekto ligjin. Thjesht nënshkruaj shkresën. Punën time e vlerëson gjykata jo ju. Po të paralajmëroj se do të të bëj kallëzim penal apo sepse po shkel ligjin. Arian Ndoja. Datë 30.9.2019”.

73. Në përfundim të hetimit administrativ, lidhur me këtë çështje, duket se bazuar në parimet e Bangalorit dhe komentarit të tij⁵⁹, të cilat zbatohen edhe për prokurorët në Shqipëri, parime të përdorura edhe në jurisprudencën e Kolegjit, subjekti ka treguar sjellje jokorrekte dhe mungesë respekti ndaj funksionit që drejtuesi përfaqëson dhe, si i tillë, ka cenuar etikën e prokurorit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr.84/2016, subjekti ka barrën e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente në lidhje me sa është konstatuar.

74. Në parashtrimet e tij, subjekti i ka paraqitur dy e-mail-e zyrtare, drejtuar nga adresa e tij zyrtare, Drejtueses së Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. A. J., të cilat sipas tij tregojnë se ka komunikuar zyrtarisht dhe në përputhje me ligjin me drejtuesen dhe se shkrimi i referuar i shkruar me shkrim dore është thjesht një pjesë e ecurisë së komunikimit me këtë shtetase. Subjekti ka sqaruar se në këto e-mail-e ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me

⁵⁸Shihni opinionin e datës 30.9.2019 të vëzhguesit ndërkombëtar në dosjen e Komisionit.

⁵⁹“109. Besimi në gjyqësor bazohet jo vetëm në kompetencën dhe zellin e anëtarëve të tij, por edhe në integritetin dhe drejtësinë e tyre morale. Gjyqtari, jo vetëm që duhet të jetë një “gjyqtar i mirë”, por edhe një “person i mirë”, edhe nëse pikëpamjet për çfarë nënkupton ky koncept mund të ndryshojnë në qarqe të ndryshme të shoqërisë. Nga këndvështrimi i publikut, një gjyqtar jo vetëm që është zotuar t’u shërbejë idealeve të drejtësisë dhe të vërtetës mbi të cilat është ndërtuar shteti ligjor dhe themelet e demokracisë, por edhe t’i mishërojë ato. Në përputhje me rrethanat, cilësitë personale, sjellja dhe imazhi që projekton gjyqtari ndikojnë në sistemin gjyqësor në tërësi dhe, rrjedhimisht, edhe vetëbesimin që publiku vendos në të. Kërkesat e publikut ndaj gjyqtarëve janë shumë më të larta sesa kërkohet nga bashkëqytetarët, standarde të sjelljes që janë shumë më të larta se ato të kërkuara të shoqërisë në tërësi. Në fakt, publiku pret një sjellje pothuajse të paqortueshme nga një gjyqtar. Vetë funksioni gjyqësor, që është gjykimi i të tjerëve, ka imponuar një kërkesë që gjyqtari të qëndrojë mbetet përtej gjykimit të arsyeshëm të të tjerëve në çështje që mund të cenojnë në çfarëdolloj mënyre funksionin gjyqësor dhe gjykatën”.

shkeljen e ligjit prej saj dhe se, nga këto e-mail-e kuptohet se ndaj tij është ushtruar presion nga të gjitha instancat e pushtetit ekzekutiv, të cilat kanë ndikuar edhe të drejtuesit e institucionit që të mos vendosej masa e sigurimit ndaj shtetasit L. P. Subjekti ka referuar dispozitat ligjore mbi pavarësinë e prokurorëve, udhëzimet e përgjithshme të detyrueshme, të drejtën e kundërshtimit të tyre nga prokurori, si dhe udhëzimet jo të detyrueshme për çështje konkrete. Subjekti ka paraqitur: e-mail të datës 27.9.2019, ora 9:28 dhe e-mail të datës 30.9.2019, ora 17:34.

75. Nga parashtrimet dhe e-mail-et e vëna në dispozicion nga subjekti, u konstatua se:

i) Nga përmbajtja e e-mailit të datës 27.9.2019, duket se subjekti ngre shqetësimin për mosnënshkrimin nga drejtuesja e prokurorisë, por edhe drejtuesit të seksionit të krimin ekonomik, të një kërkesë për caktim mase sigurimi personal në mungesë për një shtetas. Në fund të e-mail-it, shprehet se është rasti i dytë që ajo nuk jep asnjë shkak mbi mosnënshkrimin, duke i kujtuar se nuk ka asnjë dispozitë ligjore që i jep një të drejtë të tillë.

ii) Lidhur me këtë çështje, në datën 30.9.2019, Drejtuesja e Prokurorisë A. J. ka lëshuar udhëzimin me karakter jo të detyrueshëm.

iii) Po në datën 30.9.2019, në fund të këtij udhëzimi është shkruar nga subjekti me shkrim dore shënimi *“Respekto ligjin. Thjesht nënshkruaj shkresën. Punën time e vlerëson gjykata ju. Po të paralajmëroj se do të të bëj kallëzim penal apo sepse po shkel ligjin. Arian Ndoja. Datë 30.9.2019”*.

iv) Nga përmbajtja e e-mail-it të datës 30.9.2019, duket se subjekti duke e informuar drejtuesen se është njohur me udhëzimin e datës 30.9.2019, si dhe me nënshkrimin e shkresës përcjellëse në lidhje me masën e sigurimit personal në mungesë për shtetasin L. P., i bën me dije asaj se ka qenë i detyruar të shkruajë me shkrim dore në fund të kopjes së udhëzimit se do të bënte kallëzim penal nëse do të vijohej të veprohej në mënyrë të kundërligjshme. Në vijim të e-mail-it, subjekti informon mbi detaje të çështjes në lidhje me dy raste të praktikës së punonjësve të ish ALUIZNI-t Durrës dhe ASHK-së aktuale Durrës, si dhe opinionin e tij mbi masat e sigurimit ndaj një personi që nuk ishte marrë i pandehur, duke sugjeruar për referim vendime unifikuese të Gjykatës së Lartë, si dhe opinionin e tij në rast se rezultojnë çështje të ndryshme në hetim në emër të shtetasit L. P. Gjithashtu, subjekti ka kërkuar kontribuimin e drejtueses për heqjen e pengesave dhe krijimin e lehtësirave për mbarëvajtjen e hetimit, duke shmangur zvarritjen e kalimit për gjykatë të kërkesës për caktim mase sigurimi. Më tej, ai është shprehur se e përgëzon drejtuesen, që nuk e vonoi më tej nënshkrimin e shkresës përcjellëse dhe se do t'i vinte keq nëse këtë gjë do ta kishte bërë nga frika e ndonjë kallëzimi penal, pasi në të vërtetë nuk ka dashur ta frikësojë (duke i kujtuar se dikur kanë qenë shokë klase që besonin në të njëjtat vlera). Në mbyllje të komunikimit të tij, subjekti informon mbi procedime të tjera në institucion (Prokurorinë e Rrethit Durrës), të cilat kanë 2-3 vite që mbahen në hetim edhe pse ka prova e përsëri nuk veprohet.

76. Në analizë të këtyre fakteve konstatohet se është e vërtetë që në e-mail-et e dërguara drejtueses së prokurorisë subjekti ka shprehur shqetësimin e tij në lidhje me çështjen konkrete, si dhe qëndrimin e mbajtur prej saj, me të cilën duket se subjekti nuk ka rënë dakord. Por, nga Komisioni çmohet se mënyra se si subjekti i është drejtuar drejtueses së prokurorisë në datën 30.9.2019, nuk është korrekte dhe nuk përputhet me etikën e një prokurori. Për më tepër, drejtuesja e prokurorisë në udhëzimin e saj është shprehur: *“Ky udhëzim nuk është i detyrueshëm për prokurorin e çështjes; 5. Nëse prokurori nuk është dakord ose ka paqartësi lidhur me këtë udhëzim ka të drejtë të kërkojë me shkrim shpjegime të mëtejshme; 6. Në rast se prokurori, vendos të mos e ndjekë këtë udhëzim, njofton me shkrim drejtuesin e prokurorisë apo drejtuesin e seksionit, sipas rastit; 7. Udhëzimi me*

shkrim dhe përgjigjet e mundshme me shkrim të prokurorit i bashkëngjiten akteve të procedimit". Siç vërehet, ky udhëzim është në përputhje me ligjin nr. 97/2016, "Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë", i cili i jep te drejtën Drejtuesit të Prokurorisë të lëshojë udhëzime jo të detyrueshme për çështje konkrete, si dhe sanksionon pavarësinë e prokurorëve, si në vendimmarrje ashtu edhe nga pikëpamja procedurale, sikurse subjekti me të drejtë pretendon.

Në këto kushte, subjekti legjitimohej plotësisht të mbante qëndrimin e tij të pavarur nga ai i drejtueses së prokurorisë, duke mos marrë në konsideratë këtë udhëzim, si dhe kishte të drejtën të kërkonte shpjegime të mëtejshme, por nuk legjitimohej në sjelljen e tij urdhëruese e kërcënuese ndaj saj. As shpjegimet sqaruese në e-mail-in e dytë të datës 30.9.2019, sipas të cilave ai ka qenë i detyruar të mbante këtë qëndrim, nuk e justifikojnë shprehjen "*Respekto ligjin. Thjesht nënshkruaj shkresën. Punën time e vlerëson gjykata jo ju. Po të paralajmëroj se do të të bëj kallëzim penal apo sepse po shkel ligjin. Arian Ndoja. Datë 30.9.2019*". Po kështu, edhe pretendimi i subjektit se shkrimi i referuar i shkruar me shkrim dore është thjesht një pjesë e ecurisë së komunikimit me këtë shtetase vlerësohet i pabazuar, pasi prokurori në çdo komunikim si me eprorët ashtu edhe me kolegët a palët në proces, duhet të veprojë e të shprehë qëndrimin e tij bazuar vetëm në dispozita ligjore apo udhëzimet e drejtuesit të institucionit, pa cenuar etikën. Edhe në rastet kur nuk është dakord me këto udhëzime, prokurori duhet t'i referohet dispozitave ligjore për të shprehur mosdakordësinë e tij apo duke iu drejtuar organeve kompetente për veprime/mosveprime të drejtuesit që vijnë në kundërshtim me ligjin, duke u sjellë në çdo rast me integritet dhe me etikë profesionale. Për rrjedhojë, në përfundim të procesit Komisioni çmoi se në rastin objekt verifikimi, subjekti ka treguar sjellje jokorrekte dhe mungesë respekti ndaj funksionit që drejtuesi përfaqëson dhe, për rrjedhojë, ka cenuar etiken e prokurorit dhe besimin e publikut në sistemin e drejtësisë.

Informacione të marra nga artikuj të publikuar në media

77. Gjatë procesit të rivlerësimit subjekti është pyetur mbi qëndrimin e tij në lidhje me disa artikuj të publikuar në media⁶⁰, ndër të tjera, edhe mbi gjetjen e disa dosjeve të Prokurorisë së Rrethit Durrës në automjetin e tij pas atentatit të nëntorit të vitit 2019, sipas të cilëve pretendohet se këto dosje i përkasin firmës ligjore të prokurorit. Në përgjigjet e pyetësorit nr.2, subjekti ka deklaruar: "*Në lidhje me këtë fakt unë kam dhënë deklarime përpara oficerit të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Posaçme Kundër Krimin të Organizuar dhe Korrupsionit, z. P. Gj., ku edhe kam sqaruar se çfarë kanë qenë në makinën time. Njëkohësisht ka edhe një procesverbal të kthimit të sendeve të sekuestruara nga ana e prokurorit të çështjes z. A. D., ku mua më janë kthyer dokumentacioni i mjetit që i përket bashkëshortes time, dy targa të huaja të mjetit tim të mëparshëm, një targë prove, një xhup i hollë që i përket viktimës A. M. dhe dy dosje seminaresh nga trajnimi vazhdues nga Shkolla e Magjistraturës dhe asnjë material tjetër hetimor qoftë dhe i fotokopjuar, që më përket mua personalisht, bashkëshortes time, apo zyrës ku unë ushtroj funksionin tim si prokuror. Materialet e tjera i përkasin shtetasit S. D., avokat, i cili i ka marrë me procesverbal nga klienti i tij dhe janë fotokopje e një dosje penale për të cilën gjykata ka dhënë vendim, fakt të cilin e kam marrë vesh më pas. Arsyeya se përse kanë qenë në makinën time është fakti se shtetasi S. D. ka blerë automjetin e markës 'Volkswagen Tiguan' me targa ***, që e ka pasur më parë në pronësi bashkëshortja ime, dhe duke qenë se kishte pak kohë që e kishte blerë dhe kishte një zhurmë që i jepte ky mjet, i kam thënë ta dërgonte për kontroll te servisi i shtetasit D. B. P. Duke qenë se mjete ka qëndruar disa ditë dhe nuk po i gjendej shkaku i zhurmës ai ka*

⁶⁰<https://shqiptarja.com/lajm/atentati-ne-shkozetmisteri-i-tre-dosjeve-te-gjetura-ne-makinen-e-prokurorit-Arian-ndoja?r=dtr>
<https://dritare.net/Arian-ndoj-flet-per-dosjet-e-gjetura-ne-makine-pas-atentatit>
Marrë nga gazetatema.al

kërkuar që disa materiale që ishin në mjetin e tij t'ia sillte i ndjeri A. M. në Tiranë, ku ai banon dhe ka edhe zyrën e tij”.

78. Sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, nr. *** prot., datë 22.10.2021, SPAK ka informuar se: *“Gjatë kontrollit të ushtruar nga Policia Gjyqësore në mjetin me targa *** (ku subjekti udhëtonte me shtetasin P. M. / i njohur si A. L.) janë gjetur në bagazhin e tij sendet e mëposhtme: (i) një fotokopje e dosjes penale nr. *** të Prokurorisë së Rrethit Durrës, në ngarkim të të pandehurit A. M. etj. — rreth 300 faqe; (ii) fotokopje të disa seksioneve të dosjes së çështjes penale nr. ***, datë 8.7.2015, në Prokurorinë Durrës — 132 faqe gjithsej (dokumentet e kësaj çështjeje penale janë vjedhur më 24.5.2018 nga Prokuroria e Rrethit Durrës)”.*

Siç vërehet, informacioni i dhënë nga SPAK nuk përputhet me përgjigjet e subjektit dhënë në pyetësorin e dytë, kur është pyetur specifikisht për dosjet e gjetura në bagazhin e automjetit me të cilin ai po udhëtonte.

79. Në përfundim të hetimit administrativ lidhur me këtë çështje, referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar duket se: (i) ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit me faktet e vëna në dispozicion nga SPAK; si dhe (ii) mbajtja nga ana e subjektit e dokumenteve origjinale të Prokurorisë ose fotokopjeve të tyre në automjet, pra jashtë zyrës së prokurorit, tregon një mungesë të qartë të integritetit dhe të etikës së subjektit. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka barrën e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente në lidhje me këtë konstatim.

80. Në parashtrimet e tij, subjekti ka mbajtur të njëjtin qëndrim si dhe gjatë hetimit administrativ, duke deklaruar se nuk ka asnjë detyrim ligjor të vërtetojë saktësinë apo jo të këtyre shkrimeve, por sipas tij ka organe të tjera të specializuara, të cilat janë ngarkuar me ligj për të bërë një gjë të tillë. Subjekti ka bërë me dije gjithashtu se, që nga regjistrimi i procedimit penal për ngjarjen e ndodhur më 1.11.2019, ndaj tij nuk është marrë asnjë masë shtrënguese për veprën penale “vjedhje e dokumenteve zyrtare”, si dhe nuk ka asnjë procedim penal të nisur ndaj tij lidhur me këtë çështje. Përveç kësaj, subjekti ka deklaruar se në lidhje me “dosjet e vjedhura” në Prokurorinë e Rrethit Durrës, në këtë prokurori është regjistruar çështja penale për veprën penale “ndërhyrje në sistemet kompjuterike”, për të cilën është akuzuar shtetasi A. I. Sipas tij, ashtu sikurse rezulton nga vendimi Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të vitit 2019, në këtë prokurori janë vjedhur serverat (kompjuterat) dhe jo dosje.

Bashkëlidhur në parashtrimet e tij, subjekti ka paraqitur: (i) vendim për disponimin e provave materiale të datës 15.1.2021 të SPAK-ut (prokurorit A. D.), për kthimin e provave që atij i janë gjetur në automjetin ku udhëtonte në momentin e ndodhjes së ngjarjes, procesverbal për kthimin e sendeve të sekuestruara të datës 25.1.2021 të OPGJ-së P. Gj., si dhe procesverbal për listimin e provave materiale të datës 16.1.2021; (ii) kërkesë për gjykim të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me procedimin penal nr. ***, viti 2018, të prokurorëve D. P. dhe P. D. me të pandehur shtetasin A. I., akuzuar për veprën penale “ndërhyrje në sistemet kompjuterike”, si dhe vendimin nr. ***, datë 7.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës në lidhje me këtë kërkesë.

81. Në përfundim të procesit, në kushtet ekzistencës së një informacioni zyrtar nga SPAK-u, mbi ekzistencën e dosjeve penale (ose pjesë të tyre) në automjetin e subjektit, Komisioni çmon se subjekti duket të kishte evituar mbajtjen në automjetin e tij të dosjeve penale voluminoze, pavarësisht se kujt i përkasin ato. Për më tepër, pretendimi se dosjet e cituara në informacionin e referuar nga SPAK-u nuk i përkasin atij por një avokati, nuk mbështetet me ndonjë provë nga subjekti. Sa i takon informacionit të sjellë nga subjekti mbi vjedhjen e

informacioneve elektronike nga serverat e Prokurorisë së Rrethit Durrës, vlerësohet si një fakt i parëndësishëm, pasi nuk ka lidhje me mbajtjen e dosjeve fizike në automjetin e subjektit të rivlerësimit.

Informacioni i marrë nga dosja e procedimit penal nr. *, referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 21.10.2021**

82. Referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit nuk ka vepruar në mënyrë profesionale në çështjen nr. *** në shkëmbim të një shume parash.

83. Pas një analize të detajuar të akteve të këtij procedimi penal nga ONM-ja, në përfundim të hetimit administrativ, duket se subjekti ka treguar mungesë profesionalizmi, pasi: (i) ka treguar mangësi në trajtimin e procedimit penal nr. *** në drejtim të kualifikimit të veprës penale duke lehtësuar akuzën nga vepra penale “vrasje me dashje”, të mbetur në tentativë, sipas neneve 22 dhe 76 të Kodit Penal, në veprën penale “plagosje e lehtë me dashje” sipas nenit 89 të Kodit Penal; (ii) ka shpërfillur qartazi përmbajtjen e dosjes së prokurorisë pasi nuk ka identifikuar kontradiktat dhe mospërputhjet në deklaratimet e dhëna nga i pandehuri D. L. dhe vëllai i tij, M. L.; (iii) nuk ka kryer hetime të plota në lidhje me pozicionin e shtetasit M.L. (vëllai i të pandehurit). Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente në lidhje me këto konstatime.

84. Në parashtrimet e tij, lidhur me këtë çështje subjekti ka paraqitur vendimin gjyqësor nr.***, datë 29.9.2009 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit R. B.. Sipas tij, fakti i kualifikuar juridikisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës si organ akuze dhe ai i vendosur nga gjykata gjatë shqyrtimit, është i njëjtë. Edhe në masat e dënimit diferenca është shumë e vogël dhe me ulje të dënimit nga ana e gjykatës dhe jo nga ana e organit të akuzës. Sipas tij, një vendim gjyqësor nuk mund të rishikohet përtej kushteve dhe kriterëve të parashikuara në nenet 449 - 461 të Kodit të Procedurës Penale dhe se gjykata i ka pasur të gjitha mundësitë që në respektim të nenit 375 të Kodit të Procedurës Penale të ndryshonte cilësimin juridik të rastit, por, sipas tij, jo vetëm që nuk e ka bërë por edhe e ka zbutuar sadopak masën e dënimit.

85. Në analizë të parashtrimeve të subjektit, në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, u konstatua se nga përmbajtja e vendimit të gjykatës të paraqitur nga subjekti, evidentohet se i pandehuri është deklaruar fajtor nga gjykata për veprat penale “mbajtje pa leje e armëve luftarake” dhe “plagosje e lehtë me dashje”, duke i dhënë kështu faktit të njëjtin kualifikim juridik ashtu sikurse prokurori kishte kërkuar. Duke mbajtur në konsideratë pikën 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016, sipas të cilit: “... vlerësuesi çmon aftësitë profesionale të prokurorit pa gjykuar mbi korrektesinë dhe themelin e çështjes, si dhe pa zëvendësuar interpretimin ose logjikën e prokurorit që vlerësohet ...”, por edhe jurisprudencën e Kolegjit⁶¹, Komisioni çmon se kualifikimi i veprës penale është tagër ekskluziv i prokurorit dhe i përket bindjes së tij të brendshme dhe, si i tillë, duke mos qenë i një natyre procedurale, është jashtë tagrit të vlerësimit të Komisionit.

Sa i takon mangësive procedurale të evidentuara në pikat (ii) dhe (iii) të paragrafit 83, Komisioni vlerëson se ato qëndrojnë, por në konsideratë të vendimit nr. ***, të Gjykatës Kushtetuese, sipas të cilit: “*Është shumë e rëndësishme që vlerësimi negativ të bëhet vetëm në rastet e gabimeve thelbësore dhe serioze dhe/ose kur ekziston një seri e qartë dhe e*

⁶¹Shihni vendimin nr. 28, datë 23.10.2020, të Kolegjit për subjektin F. V., sipas të cilit: “... vlerësimi i aftësive profesionale të magistratit, duke gjykuar e vlerësuar logjikën apo bindjen e tij të brendshme të formuar e shpalosur si pjesë e vendimmarrjes në trupën gjyqësore përkatëse, duke arsyetuar mbi provat dhe të gjitha rrethanat e çështjes së gjykuar, del jashtë misionit dhe kompetencës ligjore të organeve të rivlerësimit, prandaj edhe Kolegji vlerëson se konkluzioni se subjekti ka dhënë një zgjidhje të gabuar, duke deklaruar pafajësinë e njërit prej të gjykuarve, është një konkluzion në tejkalim të kompetencës kushtetuese të organeve të rivlerësimit dhe, si i tillë, nuk mund të përdoret për të kryer vlerësimin e tij”.

vazhdueshme e gjykimeve të gabuara, që tregojnë mungesë të aftësive profesionale”, ato nuk janë vlerësuar mjaftueshëm si shkak për të vlerësuar subjektin të paaftë profesionalisht.

Por, referuar faktit se sipas opinioneve të vëzhguesit ndërkombëtar, si për çështjen penale në fjalë ashtu edhe për çështje të tjera të shtjelluara në këtë vendim, ka pasur të dhëna për sjellje korruptive të subjektit të rivlerësimit gjatë trajtimit të tyre, gjetjet e shprehura në paragrafin 83 të këtij vendimi, në raport edhe me fakte të tjera të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, janë mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në drejtim të cenimit të besimit të publikut nga subjekti i rivlerësimit.

Informacioni i marrë nga dosja e procedimit penal nr. *, sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar nr. *** prot., datë 8.11.2021**

86. Referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, subjekti i rivlerësimit ka vepruar në mënyrë joprofesionale në trajtimin e çështjes, në shkëmbim të një shume parash. Për këtë arsye, për të hequr çdo dyshim, ai e ka konsideruar të nevojshme analizën e çështjes së procedimit penal nr. ***, nga ku ka rezultuar se:

- Oficeri i policisë gjyqësore ka raportuar mbi hetimin në lidhje me procedimin penal që i referohet çështjes së shtetasve A. M. (e mitur) dhe A. S., duke sugjeruar dërgimin në gjykatë të shtetasit T. L. për veprat penale “ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” sipas nenit 298/2 të Kodit Penal; “falsifikim të dokumenteve” sipas nenit 186/2 të Kodit Penal; dhe “largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit” sipas nenit 323/1 të Kodit Penal.

- Bazuar në nenin 327 të Kodit të Procedurës Penale, prokurori F. L. ka vendosur më 17.7.2009 të dërgojë për gjykim pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës procedimin penal nr. *** kundër shtetasit T. L. për veprat penale “falsifikim të dokumenteve” dhe “largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, sipas parashikimeve të neneve 186/1 dhe 323 të Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

- Konkluzionet përfundimtare të datës 28.9.2009⁶² përpara Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës janë nënshkruar nga prokurori F. L. dhe Drejtuesi i Prokurorisë së Rrethit Arian Ndoja.

- Në lidhje me rrethanat e çështjes konstatohet se më 5.11.2008 policia kufitare në ***, Shkodër, ka ndaluar shtetasit A. M. dhe A. R. pasi ishin drejtuar për në ***. Arsyeja ishte mbi dyshime se shtetasja A. M. (17 vjeç, pasi ishte minorene në atë kohë), për shkak të moshës të saj, do të udhëtonte në Itali për shfrytëzim prostitucioni dhe nuk kishte dokument për dhënie pëlqimi nga anëtarët e familjes (nëna e saj kishte ndërruar jetë dhe babai i saj ishte dënuar për vrasje, halla e saj jetonte në Itali në kohën e ngjarjes). Për shkak të dyshimeve për shfrytëzim prostitucioni, të dy shtetasit janë shoqëruar pranë Drejtorisë së Policisë Shkodër. Ajo ka deklaruar se po udhëtonte drejt *** dhe me ndihmën e shtetasit T. L. do shkonte në Itali të të afërmit e saj.

- Prokuroria e Rrethit Shkodër ka regjistruar procedimin penal nr. *** për veprën penale “trafikim i femrave” sipas nenit 114/b të Kodit Penal kundër shtetasit I. D. Për shkak të mungesës së kompetencës territoriale, ky procedim penal i është transferuar Prokurorisë së Rrethit Durrës dhe më 7.11.2008, procedimi penal nr. *** është regjistruar kundër shtetasit I.D.

⁶²Referuar dokumentacionit të paraqitur nga KLP-ja në lidhje me praktikën e pezullimit nga detyra të subjektit, ka rezultuar që: (i) subjekti është pezulluar nga detyra e drejtuesit të Prokurorisë me urdhrin e datës 25.11.2008; (ii) procedimi penal nr.***, i vitit 2008 në ngarkim të tij është pushuar në datën 3.2.2009; (iii) pas ankimit të këtij vendimi nga ILDKPKI-ja, nga drejtuesi i inspektimit pranë Prokurorisë së Përgjithshme, në datën 26.2.2009, i është sugjeruar Prokurorisë së Përgjithshme lënia në fuqi e vendimit të prokurorit; (iv) nuk ka akt të mëvonshëm nga Prokuroria e Përgjithshme për rikthimin në detyrën e drejtuesit.

- Në datën 8.11.2008, Prokuroria e Rrethit Durrës ka regjistruar procedimin penal nr. *** kundër shtetasit T. L. për veprën penale “ndihma për kalim të paligjshëm të kufijve” sipas nenit 298/3 të Kodit Penal, procedimet penale janë bashkuar në një procedim penal të vetëm me nr. ***.

- Nga hetimet e kryera dhe pyetjet e personave që kanë qenë të përfshirë në hetim rezulton se prokurori i ngarkuar për këtë çështje ka konkluduar se: *“Nuk gjenden elementë të veprës penale ‘ndihmë në kalim të paligjshëm të kufirit’ sepse shtetasit A. M. dhe A. R. rezultojnë të kenë paraqitur dokumentet përkatëse të rregullta pranë autoriteteve kufitare shqiptare dhe kanë respektuar procedurat ligjore përkatëse për të kaluar në mënyrë të rregullt kufirin nga Shqipëria për në Malin e Zi, pra nuk janë munduar të kalojnë në mënyrë të paligjshme kufirin për në Malin e Zi”*. Gjithsesi, rezulton se shtetasja A. M. u kthye nga kufiri i Malit të Zi.

- Për më tepër, prokurori i çështjes F. L. ka cituar vendimin nr. ***, datë 2.4.2008, të Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë dhe në referencë të nenit 298 për veprën “ndihmë në kalimin e paligjshëm të kufirit” të Kodit Penal dhe ka argumentuar si më poshtë cituar nga dosja: *“(…) Nga tërësia e veprimeve hetimore të kryera, si dhe deklarimeve të marra nuk kemi të bëjmë me elemente të veprës penale ‘Dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të kufirit’, që parashikohet nga neni 298/3 i Kodit Penal, pasi shtetasit A. M. dhe A. R., kanë paraqitur dokumentacion të rregullt pranë autoriteteve kufitare dhe kanë respektuar procedurat ligjore për kalimin e kufirit shqiptar për territorin e Malit të Zi. Ata nuk kanë tentuar të kalojnë në mënyrë të paligjshme territorin shqiptar. Kolegji Penal i Gjykatës së Lartë në vendimin nr. ***, datë 2.4.2008, në lidhje me nenin 298 të Kodit Penal. Personi nën hetim T.L. do të ndihmonte shtetasen A. M. për të kaluar në mënyrë të paligjshme kufirin e Malit të Zi. Përderisa nuk kemi kalim të paligjshëm të kufirit shqiptar, nuk mund të kemi dhënie ndihme për kalim të paligjshëm të këtij kufiri.*

Me urdhrin e datës 11.11.2008 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës është urdhëruar ndalimi i shtetasit T. L., i cili u fshihej hetimeve.

Në datën 6.1.2009 është bërë i mundur ndalimi i shtetasit T. L. Gjatë ndalimit iu gjeten me vete sende, të cilat iu sekuestruan në cilësinë e provës materiale, si fotografi dhe fotokopje e pasaportës së shtetasit A. (A.) S. dhe një sasi e konsideruar të hollash.

Pas identifikimit dhe pyetjes me cilësinë e personit që ka dijeni mbi rrethanat e hetimit, shtetasi A. S. deklaroi se i kishte dhënë një shtetasi me emrin I. (ky i fundit i njohur nga T., shtetasi T. L.) një sasi prej 240.000 lekësh të reja, për t’i mundësuar shkuarjen në Itali. T.L. (I.) i kishte siguruar A. S. një leje qëndrimi për në Greqi, të cilën A. i do ta vendoste në pasaportë, pasi të mbërrinte në Itali. T. L. dhe A. S. e kishin lënë për t’u takuar në ditët në vazhdim dhe për të vendosur përfundimisht mbi mënyrën se si A. S. do të kalonte në shtetin italian. Indriti i propozonte atij variante të ndryshme kalimi.

Megjithëse nuk rezulton e provuar që T. L. ka falsifikuar lejen e qëndrimit për në shtetin grek në emër të A. S., për të kaluar ilegalisht kufirin, pasi ky i fundit në të vërtetë nuk e ka kaluar kufirin shqiptar ilegalisht, është vërtetuar se T. L. kishte falsifikuar lejen e qëndrimit për në Greqi në emër të A. S. dhe kishte marrë para për këtë, por nuk u vërtetua se ai kishte kryer veprime konkrete si strehim, shoqërim apo vënie në dispozicion të ndonjë mjeti udhëtimi, sipas nenit 298 të Kodit Penal. Lejen e falsifikuar të qëndrimit i është këshilluar nga T. A. për ta vendosur në pasaportën e hyrjes në Greqi. Premtimi për të ndihmuar në kalimin e paligjshëm të kufirit nuk e ngarkon me përgjegjësi penale.

*Në bazë të kërkesës së avokatit të të pandehurit, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës ka vendosur me vendimin nr. ***, datë 22.5.2009, për vendosjen e masës së sigurisë ‘arrest me burg’, sipas vendimit të datës 9.1.2009 ndaj T. L. me masën e sigurisë ‘arrest në shtëpi’.*

Në datën 8.6.2009, T. L. u arrestua në flagrancë për veprën ‘arratisje nga vendi i paraburgimit’ të parashikuar në nenin 323 të Kodit Penal. Organi i prokurorisë kërkoi shpalljen fajtor të T. L. për veprat penale ‘falsifikim të dokumenteve’ dhe ‘arratisje nga vendi i kryerjes së dënimit’ sipas neneve 186/1 dhe 323 të Kodit Penal”.

87. Në analizë të të dhënave si më sipër, evidentohet si vijon:

87.1. Prokurori i çështjes në konkluzionet e tij i është referuar vendimit nr. *** të Gjykatës së Lartë dhe ka deklaruar se: “(...) *Në lidhje me dhënien e ndihmës për kalimin e paligjshëm të kufijve, ligjvënësi i referohet mbrojtjes së marrëdhënieve sociale në territorin dhe kufirin e Republikës së Shqipërisë dhe jo për kufijtë e shteteve të tjerë. T. L. po ndihmonte A. për të kaluar ilegalisht kufirin e Malit të Zi. Meqenëse nuk ofrohet ndihmë për të kaluar ilegalisht kufirin shqiptar, por kufirin e Malit të Zi. Në lidhje me vendimin e Dhomës Penale të Gjykatës së Lartë nuk janë konsumuar elementet e veprës së parashikuar nga neni 298/3 i Kodit Penal”.*

87.2. Nga shqyrtimi i këtij vendimi dhe kuadrit ligjor përkatës, konstatohet se gjykata ka rrëzuar vendimet e vitit 2005 të gjykatave të tjera më të ulëta, duke arsyetuar një çështje të vitit 2003. Parimi i shtjelluar në Gjykatën e Lartë nuk mund të zbatohet në çështjen në fjalë lidhur me shtetasin T. L., pasi ngjarjet në këtë rast ndodhën në vitin 2008 dhe neni 298 i Kodit Penal në këtë kohë kishte ndryshuar (në vitet 2004⁶³ dhe 2007⁶⁴) dhe nocioni i veprave penale është “zgjeruar”/shtrirë më shumë, duke mbuluar edhe kalimin e paligjshëm të kufijve nga Shqipëria. Duhet të mbahet parasysh se shtetasja A. M. u kthye nga kufiri shqiptar në ***, sipas dokumentacionit në dosje. Pra, prokurori i çështjes në konkluzionet e tij nuk iu referua ndryshimeve të vitit 2007 të kësaj dispozite ligjore. Pavarësisht mospërputhjes mes konkluzioneve të prokurorit të çështjes me konkluzionet e oficerit të policisë gjyqësore, fakti që shtetasi T. L. ishte fshehur (nuk ishte përmendur) në fillim të hetimeve, kërkesa për zëvendësimin e masës së sigurisë nga “arrest me burg” me “arrest shtëpie” është mbështetur edhe nga prokuroria.

87.3. Bazuar në sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e prokurorit të rrethit, që ka miratuar edhe konkluzionet si prokuror i çështjes, nuk ka respektuar dispozitat ligjore: (i) nenin 24/5 të Kodit të Procedurës Penale në fuqi, që parashikon që prokurori më i lartë ka të drejtë të ndryshojë ose të rimodelojë vendimin e prokurorit më të ulët; (ii) udhëzimin nr. ***, datë 8.3.2007 “Për përmirësimin e punës së prokurorit dhe mbikëqyrjen e prokurorit në hetimin penal” të Prokurorit të Përgjithshëm; (iii) urdhrin nr. ***, datë 9.5.2008, “Për unifikimin e ushtrimit të funksioneve të prokurorëve në prokuroritë e shkallës së parë”.

88. Në përfundim të hetimit administrativ, referuar analizës së akteve të procedimit penal nr.***, nga vëzhguesi ndërkombëtar duket se subjekti i rivlerësimit ka treguar mungesë të

⁶³Pas ndryshimeve të vitit 2004, neni 298 i Kodit Penal është si vijon: “*Ndihma për kalimin e paligjshëm të kufirit – strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të transportit detar, transportit ajror ose mjeteve të tjera të transportit, me qëllim të ndihmës në kalimin e paligjshëm të kufirit – dënohet me burgim nga një deri në katër vjet dhe me gjobë nga 3-6 milionë lekë. Kur ndihma jepet për qëllime përfitimi, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga 4 milionë deri në 8 milionë lekë.*

⁶⁴Me amendimet e vitit 2007, në Kodin Penal, fjala kufi u zëvendësua me kufij (në shumës) dhe dispozita është si vijon: “*Ndihmë në kalimin e paligjshëm të kufijve – strehimi, shoqërimi, vënia në dispozicion ose përdorimi i mjeteve të transportit detar, ajror ose mjeteve të tjera të transportit, me qëllim të ndihmës në kalimin e paligjshëm të kufijve të Republikës së Shqipërisë ose në hyrjen e paligjshme të personit në një vend tjetër pa qenë shtetas i tij ose pa leje qëndrimi/rezidencë në atë vend, dënohet me burgim nga një deri në katër vjet. Kur ndihma jepet për qëllime përfitimi, dënohet me burgim nga tre deri në shtatë vjet dhe me gjobë nga 4 milionë e deri 8 milionë lekë [. .) (shtuar shkronja të zeza).*

aftësive profesionale në trajtimin e kësaj çështjeje, pasi me mosushtrimin e kompetencave korigjuese si prokuror epror/mbikëqyrës në përputhje me dispozitat në fuqi në lidhje me referencën e gabuar të prokurorit të çështjes në një vendim të vjetër të Gjykatës së Lartë (që nuk ka më vlerë ligjore) për zgjidhjen e çështjeve të ngjashme, ka mbrojtur autorët e të njëjtit krim në rrethana të ngjashme. Për më tepër, shqetësues është fakti se subjekti i rivlerësimit, në rolin e tij në vitin 2008 si prokuror epror/mbikëqyrës, nuk e nxiti kolegun përgjegjës të çështjes të hetonte më tej për ekzistencën e trafikimit të personave apo krimeve të tjera përfshirë edhe ekzistencën e grupeve të strukturuar kriminale. Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës për të dhënë sqarime e paraqitur dokumente për të vërtetuar të kundërtën e këtyre konstatimeve.

89. Në parashtrimet e tij, lidhur me këtë çështje subjekti ka paraqitur vendimin gjyqësor nr.***, datë 28.9.2009, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës të gjyqtarit N. Gj. Sipas subjektit, fakti i kualifikuar juridikisht nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës si organ akuze dhe ai i vendosur nga gjykata gjatë shqyrtimit, është i njëjtë. Po ashtu, sipas tij edhe në masat e dënimit diferenca është shumë e vogël dhe me ulje të dënimit nga gjykata dhe jo nga ana e organit të akuzës. Ndërkohë, nga Gjykata e Apelit Durrës, me vendimin e saj nr. ***, datë 8.11.2011, është vendosur mospranimi i ankimit për shkak të heqjes dorë nga ankuesi. Më tej, subjekti ka deklaruar se nuk ka asnjë njohje me të pandehurin ose të afërm të tij dhe se ndaj tij nuk ka asnjë procedim penal të regjistruar për korrupsion pasiv në lidhje me këtë shtetas dhe për këtë çështje. Mendimi i tij juridik si drejtues ka qenë i njëjtë me atë të prokurorit të çështjes dhe organi i vetëm që e vlerëson kualifikimin ligjor të rastit është vetëm gjykata, që në rastin konkret e ka të njëjtë qëndrimin me organin e akuzës, madje lehtësisht zbutës në lidhje me masën e dënimit.

90. Në analizë të deklarimeve të subjektit dhe nga përmbajtja e vendimit të gjykatës të paraqitur nga subjekti, konstatohet se i pandehuri T. L. është deklaruar fajtor për veprat penale “falsifikim i dokumenteve” dhe “largim i të burgosurit nga vendi i qëndrimit”, duke i dhënë kështu faktit të njëjtin kualifikim juridik ashtu sikurse prokurori i çështjes kishte kërkuar.

Megjithatë, subjektit, me njoftimin e barrës së provës, nuk i janë kërkuar sqarime lidhur me faktin e kualifikimit të veprës penale, por me mosushtrimin prej tij të kompetencave mbikëqyrëse në cilësinë e drejtuesit të prokurorisë, konkretisht, të referencës së gabuar ligjore të prokurorit të çështjes, fakt për të cilin subjekti konfirmoi se i qëndron opinionit juridik të prokurorit të çështjes. Pavarësisht kësaj, në përfundim të procesit në konsideratë të vendimit nr. ***, të Gjykatës Kushtetuese, u vlerësua se mosveprimet e subjektit si drejtues prokurorie sipas përcaktimit në paragrafin 88 të vendimit, nuk përbejnë shkak për cenimin e aftësive profesionale të subjektit, pasi përbejnë një rast të vetëm të evidentuar të kësaj natyre. Por, referuar faktit se, sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar subjekti i rivlerësimit, në rastin konkret, ka vepruar në mënyrë joprofesionale si pasojë e një sjelljeje korruptive, këto mosveprime, në raport edhe me fakte të tjera të evidentuara gjatë procesit të rivlerësimit, janë mbajtur në konsideratë në vlerësimin tërësor të çështjes në drejtim të cenimit të besimit të publikut.

Informacioni i marrë nga të dhënat e dosjes hetimore në SPAK, në lidhje me tentativën e vrasjes së subjektit të rivlerësimit në datën 1.11.2019, referuar opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar nr. * prot., datë 11.11.2021**

91. Bazuar në informacionin e marrë prej SPAK-ut, nga Vëzhguesi Ndërkombëtar është konstatuar se subjekti i rivlerësimit:

91.1. Ka pasur disa kontakte telefonike dhe/ose në *Whatsapp* me drejtues politikanë vendorë, magistratë dhe persona të tjerë nën hetim nga prokuroria, sidomos gjatë periudhës 2018 - 2019, konkretisht me:

- Politikanë vendorë, duke përfshirë: (i) z. V. D., ish-kryetar i Bashkisë së ***, i cili ka mbajtur këtë pozicion deri më 2.8.2019, pas deklarimit si person *non grata* nga SHBA-ja (Departamenti i Shtetit). Këto telefonata kanë ndodhur disa herë gjatë periudhës tetor 2018 - tetor 2019⁶⁵; (ii) z. R. K. (Kryetar i Bashkisë së *** nga gushti i vitit 2019 dhe kandidat që nga maji i vitit 2019) dhe telefonatat kanë ndodhur në periudhën korrik - tetor 2019⁶⁶; (iii) z. G. V. (avokat dhe anëtar i K.Q.Z. nga viti 2015), këto telefonata kanë ndodhur në periudhën shtator - tetor 2019⁶⁷; (iv) z. S. K. (Kryetar i Bashkisë së *** në vitin 2011 i angazhuar me P.D. dhe më pas me B. D. – parti e re e krijuar nga z. A. P. në vitin 2019, si një alternativë e PD-së), në periudhën gusht - shtator 2019⁶⁸; (v) z. A. M. (Kryetar i Këshillit të Qarkut *** dhe anëtar i Këshillit Bashkiak *** në periudhën 2013 – 2021), telefonatat kanë ndodhur në periudhën tetor 2018 - qershor 2019⁶⁹.

- Gjyqtarë dhe prokurorë, duke përfshirë: (i) z. A. C., bashkëshorti i znj. M. M., gjyqtare, të dy nën hetim nga SPAK, në periudhën tetor 2018 - nëntor 2019. Nuk përjashtohet që mund të ketë konflikt interesi të mundshëm lidhur me këtë, i cili mund të ndodhë ose mund të ketë ndodhur më parë⁷⁰.

- Persona të tjerë të hetuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës si S. D., avokat, aktualisht (2020 - 2021) nën hetim nga SPAK për vepra penale të lidhura me korrupsionin, së bashku me gjyqtaren M. M. dhe bashkëshortin e saj A. C., të përmendur më lart, në periudhën shtator 2019⁷¹.

91.2. Subjekti i rivlerësimit kishte në dispozicion (me anën e mjeteve elektronike) të dhëna, informacione dhe kopje të dokumenteve, duke përfshirë dokumente të lidhura me hetime çështjesh, disa prej të cilave nuk ndiqen ose ndiqen drejtpërdrejt prej tij, si vijojnë:

⁶⁵Thirrjet në *WhatsApp* kanë ndodhur si vijojnë: datë 4.10.2018 (subjekti telefonon D., telefonata e humbur, f. 677); datë 24.5.2019 (subjekti telefonon D., telefonatë e humbur. Më pas, D. telefonon subjektin për 1:15 min); datë 18.7.2019 (subjekti telefonon dy herë D., nuk flet). Më pas D. telefonon subjektin, flet për 36 sekonda); datë 20.9.2019 (e telefonon subjektin, thirrje e humbur); datë 21.10.2019 (D. e telefonon dy herë – foli 1 min 12 sek., f. 401); datë 23.10.2019 (e merr D. në telefon – telefonata e humbur). Ju lutemi vini re: faqet e përmendura në të gjitha footnotat janë referencë e njëjtë e dosjes hetimore të SPAK-ut, kjo vlen njëjloj për të gjitha footnotat e tjera.

⁶⁶Datë 24.7.2019 (K. e telefonon – telefonatë e humbur. Subjekti merr në telefon K., bisedojnë për 39 sek. Më pas K. merr subjektin, bisedojnë për 12 sekonda); datë 29.7.2019 (subjekti merr K., telefonatë e humbur. Pastaj K. dhe subjekti bisedojnë për 1.27 min); datë 6.9.2019 (K. e telefonon, bisedojnë 1.22 min); datë 7.10.2019 (subjekti telefonon K., telefonatë e humbur (pa përgjigje). Disa sekonda më pas K. e merr subjektin – bisedojnë për 1 min 6 sekonda, f. 41 1).

⁶⁷Datë 16.9.2019 (e merr në telefon V., thirrje e refuzuar); datë 17.9.2019 (V. e merr në telefon, bisedë 35 sek, f. 441); datë 25.9.2019 (thirrje V., telefonata refuzohet); datë 1.10.2019 (e telefonon V., refuzohet telefonata).

⁶⁸Datë 28.8.2019 (4 thirrje të humbura nga subjekti për Kacaj, një telefonatë nga subjekti drejt K. prej 59 sekondash); datë 24.9.2019 (e merr K., telefonatë e refuzuar. Pas 2 orësh thirrje e subjektit, bisedoni 1.49 min).

⁶⁹Datë 9.10.2018 (subjekti e merr në telefon dhe bisedon); datë 11. 10.2018 (subjekti e merr dhe bisedojnë); datë 15.6.2019 (telefonata M., telefonata e humbur f. 543).

⁷⁰Datë 23.10.2018 (telefonojnë njëri-tjetrin 4 herë dhe bisedojnë); datë 24.10.2018 (telefonojnë njëri-tjetrin dhe bisedojnë); datë 4.12.2018 (telefonata nga C., thirrje e humbur); datë 12.12.2018 (vlerësuesi e merr në telefon dhe bisedojnë); datë 4.3.2019 (telefonojnë njëri-tjetrin 5 herë dhe bisedojnë); datë 1.3.2019 (telefonojnë 3 herë njëri-tjetrin dhe bisedojnë); datë 12.3.2019 (telefonata vlerësuese, telefonata e humbur); datë 1.3.2019 (thirrmi njëri-tjetrin dy herë dhe bisedojnë); datë 25.3.2019 (telefonatë nga C.); datë 26.3.2019 (marrin njëri-tjetrin dhe bisedojnë); datë 29.3.2019 (subjekti e telefonon dhe bisedojnë); datë 27.3.2019 (marrin njëri-tjetrin 4 herë dhe bisedojnë); datë 1.4.2019 (marrin njëri-tjetrin 3 herë dhe bisedojnë) datë 11.4.2019 (telefonata e subjektit, telefonatë e humbur); datë 15.4.2019 (telefonojnë njëri-tjetrin, telefonatat e humbura). Pastaj subjekti e telefonon, bisedojnë për 1.53 min. Përsëri, subjekti e telefonon dhe bisedojnë për 29 sekonda); datë 10.6.2019 (vlerësoni thirrjet, thirrjet e humbura. Më pas C. telefonon, bisedoni për 2.12 min); datë 1.11.2019 (C. e merr, f. 385).

⁷¹Datë 6.9.2019 (D. e merr në telefon 2 herë, *missed calls*).

- Një kallëzim penal nga shtetasit A. Sh., Xh. M., etj., kundër shtetasit A. T. për disa prona, në të cilin nuk kuptohet mirë përfshirja e subjektit të rivlerësimit si prokuror⁷².
- Vendimi i kolegut të subjektit të rivlerësimit, prokurorit A. Sh., për të cilin nuk është e qartë përfshirja e subjektit si prokuror⁷³.
- Një urdhër pezullimi i ZVRPP-së Durrës, datë 25.9.2019, ndaj shtetas L. K., deri në përfundimin e procedimit penal ndaj saj, lidhur me një hetim të kryer nga prokurori A. Sh. dhe, për të cilin, nuk është e qartë përfshirja e subjektit të rivlerësimit si prokuror.
- Disa dokumente pronësie që i përkasin shtetasve Z. Gj. (në Durrës) dhe J. N., për të cilët nuk është e qartë përfshirja e subjektit të rivlerësimit si prokuror.
- Një video e muajit qershor 2019, e tentativës për vrasjen e shtetasit P. D. dhe bashkëpunëtorëve të tij. Shtetasit P. D., J. M. dhe B. H. janë aktualisht nën hetim nga SPAK-u për çështjen e Ndojës dhe të akuzuar nga Ndoja si urdhëruesit e sulmit ndaj tij. Nuk është e qartë se kush ia ka dërguar videon subjektit të rivlerësimit dhe nëse është dërguar në të njëjtën ditë kur ka ndodhur sulmi ndaj D., datë 20.6.2020 apo në një moment të mëvonshëm.
- Një video me disa persona që djegin një automjet.
- Dy foto të një personi me kapele që nuk identifikohen dhe që duket se i ka në dispozicion elektronikisht edhe shtetasi A. L. (*Alias* P. M.).
- Një vendim për shtyrjen e hetimeve nga prokurori i Elbasanit B. M., për të cilin nuk është e qartë përfshirja e të dyshuarit si prokuror⁷⁴.

91.3. Ashtu sikurse është gjatë hetimit administrativ, u administruan prova dhe fakte sipas të cilave, duket se subjekti i rivlerësimit mban kontakte me persona me precedentë penalë, si A. L. (D.), E. Sh./Sh., D. B. P. dhe M. V., për më tepër, gjatë periudhës që ka qenë duke ushtruar detyrën e prokurorit.

92. Në analizë të të dhënave si më sipër, referuar: (i) natyrës së dyshimtë të kontakteve me personat e lartpërmendur, përfaqësues të pushtetit vendor, gjyqtarë e prokurorë; (ii) natyrës së dyshimtë të të dhënave, informacioneve dhe dokumenteve në posedim të subjektit të rivlerësimit, të cilat duhet të shpjegohen nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të rolit, detyrave dhe përgjegjësi të një magjistrati, si dhe përshtatshmërisë me figurën e një magjistrati; (iii) kontakteve me persona të përfshirë apo të dyshuar të përfshirë në veprimtari kriminale, vëzhguesi i ONM-së ka kryer një vlerësim të etikës së subjektit si vijon:

[...] Referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, etika nuk zbatohet vetëm në përmbushjen e detyrave të gjyqësorit dhe prokurorisë. Ato, gjithashtu, përfshijnë sjelljen në jetën private dhe aktivitetet jashtëgjyqësore. Gjyqtarët dhe prokurorët, përveç respektimit të ligjit si çdo person tjetër, duhet të sillen me integritet, ndershmëri, vetëpërmbytje dhe diskrecion, si gjatë dhe jashtë ushtrimit të detyrës⁷⁵. Në lidhje me parimin e integritetit, i referohet më tej ndershmërisë, dinjitetit dhe nderit në jetën private dhe shoqërore të një gjyqtari dhe prokurori.

⁷²Kallëzimi penal është protokolluar nga Prokuroria e Durrësit më 6.4.2018. Fotoja ka datën në shtator *pdf.embedded*, në celular.

⁷³Sipas përshkrimit të Prokurori-së, ky vendim i Sh. mban datën 14.10.2019, ndërsa fotografia e vendimit në celularin e të vlerësuarit është e datës 24.10.2019.

⁷⁴Fotoja e vendimit është e datës 23.9.2019.

⁷⁵Në lidhje me gjyqtarët, shihni Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndjekur jurisprudencën e saj të mëparshme në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë* (vendimi i datës 26.9.1995, Dhoma e Madhe, aplikimi nr. ***) dhe çështjen *Kurtulmus kundër Turqisë* (vendimi i datës 24.1.2006, aplikimi nr. ***), mbajtur në çështjen *Ozpinar* (vendimi i datës 19.10.2010, aplikimi nr. ***, në paragrafin 71), që magjistratët kanë detyrë të rezervohen edhe në jetën e tyre private.

Nuk është e lehtë të precizohet përmbajtja e saktë e parimeve të sipërpërmendura dhe as nuk ekziston një përkufizim shterues, përveçse ekzistencës së një numri shembujsh⁷⁶. Kjo është kryesisht për shkak të faktit se këto parime, në fakt, reflektojnë standardet morale që gjyqtarët dhe prokurorët (mutandis mutandis) pritet të përmbushin. Standardet morale variojnë nga koha në kohë dhe vendi në vend. Ajo çka rekomandohet në këto raste është të zbatohet testimi i një personi të arsyeshëm, të paanshëm dhe të informuar, për të testuar 'se si një sjellje e caktuar do të perceptohej nga një anëtar i arsyeshëm, i paanshëm dhe i informuar i pjesëtarëve të komunitetit dhe nëse ai perceptim do të çonte në zvogëlimin e respektit për gjyqtarin ose gjyqësorin në tërësi'⁷⁷.

Testi i mësipërm, edhe pse parashikohet nga Komentari i Bangalorit i vitit 2007 nga Zyra e Kombeve të Bashkuara e Drogës dhe Krimin (UNDOC) mbi Parimet e Bangalorit mbi Sjelljen Gjyqësore, mund të zbatohet mutandis mutandis për prokurorët.

Gjithashtu, sjellje të dyshimta, të pajustificuara jo në përputhje me rolin, funksionet, detyrat dhe figurën e një prokurori (si p.sh., kontakte me politikanë të cilët nuk justifikohen nga ushtrimi i funksionit të një magjistrati) kanë, gjithashtu, një ndikim negativ në vlerësimin e etikës dhe atë të përgjithshëm të një prokurori në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Vëzhguesi Ndërkombëtar është në dijeni të kufizimeve të nenit 8 të Konventës Evropiane të të Drejtave dhe Lirive Themelore të Njeriut sa i takon personave (duke përfshirë politikanë dhe funksionarë publikë), të cilët mund të kenë ndërvepruar me subjektin e rivlerësimit [...].

93. Në përfundim të hetimit administrativ, nisur nga të gjitha faktet e sipërpërmendura, sipas opinionit të vëzhguesit ndërkombëtar, duket se subjekti me veprimet e tij ka cenuar etikën e prokurorit, duke cenuar rëndë besimin e publikut, referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut^[1] dhe parimeve të Bangalorit^[2], sipas të cilave:

- Kontaktet e papërshtatshme me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përshirë në krimin e organizuar dhe në aktivitete kriminale në përgjithësi, mund të ndikojnë negativisht dhe cenojnë standardet e sjelljes dhe, prandaj, kanë një ndikim negativ në vlerësimin e etikës së një prokurori.

- Sjelljet e dyshimta, të pajustificuara dhe jo në përputhje me rolin, funksionet, detyrat dhe figurën e një prokurori (si p.sh., kontakte me politikanë, të cilët nuk justifikohen nga ushtrimi

⁷⁶Shihni: Parimet Bangalore të Sjelljes Gjyqësore, miratuar në vitin 2002 (në dispozicion në: www.unodc.org); opinioni nr. 3 i CCJE-së në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtuashme dhe paanshmërinë, miratuar në vitin 2002 (e disponueshme në: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccje/texte_vis_en.asp), paragrafi 29; Grupi i Punës i ENCJ, Raporti i Etikës Gjyqësore 2009-2010, i disponueshëm në www.ency.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf. Ato parime mund të zbatohen, *mutatis mutandis*, edhe për prokurorët.

⁷⁷UNODC, Komentari mbi Parimet e Bangalore të Sjelljes Gjyqësore, viti 2007, paragrafi 102. Paragrafi i mëposhtëm. 103 (me titull Kërkohej standarde të larta si në jetën private ashtu edhe në atë publike) shprehet se: "103. Një gjyqtar duhet të mbajë standarde të larta në jetën private dhe publike. Arsyeja për këtë qëndron në një gamë të gjerë të përvojës njerëzore dhe sjelljes mbi të cilat një gjyqtari mund t'i kërkohej të gjykojë. Nëse gjyqtari do të dënojë publikisht atë që ai ose ajo praktikon privatisht, gjyqtari do të shihet si hipokrit. Kjo në mënyrë të pashmangshme çon në humbjen e besimit të publikut te gjyqtari, i cili mund të dëmtojë edhe gjyqësorin në përgjithësi". Siç u tha, ato standarde mund të zbatohen *mutatis mutandis* edhe për prokurorët.

[1] Në lidhje me gjyqtarët, shihni Gjykatën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, duke ndjekur jurisprudencën e saj të mëparshme në çështjen *Vogt kundër Gjermanisë* (vendimi i datës 26.9.1995, Dhoma e Madhe, aplikimi nr. ***) dhe çështjen *Kurtulmus kundër Turqisë* (vendimi i datës 24.1.2006, aplikimi nr. ***), mbajtur në çështjen *Ozpınar* (vendimi i datës 19.10.2010, aplikimi nr. ***, në paragrafin 71) që magjistratët kanë detyrë të rezervohen edhe në jetën e tyre private.

[2] Shihni: Parimet Bangalore të Sjelljes Gjyqësore, miratuar në vitin 2002 (në dispozicion në www.unodc.org); opinioni nr. *** i CCJE-së në vëmendje të Komitetit të Ministrave të Këshillit të Evropës mbi parimet dhe rregullat që rregullojnë sjelljen profesionale të gjyqtarëve, në veçanti etikën, sjelljen e papajtuashme dhe paanshmërinë, miratuar në vitin 2002 (e disponueshme në: http://www.coe.int/t/dghl/cooperation/ccje/texte_vis_en.asp), par. 29; Grupi i Punës i ENCJ, Raporti i Etikës Gjyqësore 2009-2010, i disponueshëm në www.ency.eu/images/stories/pdf/ethics/judicialethicsdeontologiefinal.pdf. Ato parime mund të zbatohen, *mutatis mutandis*, edhe për prokurorët.

i funksionit të një magjistrati) kanë, gjithashtu, një ndikim negativ në vlerësimin e etikës dhe atë të përgjithshëm të një prokurori në kuadër të procesit të rivlerësimit.

Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit i është kërkuar të paraqesë dokumente e të japë sqarime në lidhje me: (i) arsyet e kontakteve të çdolloji të përmendura më sipër; (ii) tagrat e posedimit të dokumenteve/videoeve të përmendura në këtë akt dhe nëse ka qenë ose jo i implikuar në këto çështje, me qëllim vlerësimin sa më objektiv nga Komisioni të figurës së tij si prokuror dhe perceptimin e besimit të publikut ndaj imazhit të tij si pjesë përbërëse e sistemit të drejtësisë.

94. Në parashtrimet e tij, në mënyrë të përmbledhur, subjekti ka deklaruar se njohja e tij me shtetasit e referuar nga Komisioni ka ardhur për shkak të cilësisë së tij si drejtues i prokurorisë, për shkak të njohjes gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit ose mësimdhënies, konkretisht, si vijojnë:

- Me shtetasit V. D. dhe A. M., njohja ka qenë për shkak të qenies së tij si drejtues, ndërkohë që ata kanë përfaqësues të organeve vendore.

- Me shtetasin S. K., njohja ka qenë gjatë kohës së ushtrimit të profesionit të lirë të avokatit.

- Me shtetasin G. V., njohja ka qenë gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, pasi në atë kohë edhe ai ka qenë avokat.

- Në lidhje me shtetasin A. C., ai ka qenë drejtues i departamentit të së drejtës penale në universitetin “A. M.”, Durrës, ku edhe subjekti qenë pedagog dhe lidhja e tyre ka qenë lidhje pune dhe komunikim normal kolegësh. Ai informon se me bashkëshorten e tij ka pasur marrëdhënie pune sepse kanë punuar në një godinë dhe ai ka marrë pjesë në shumë gjyqe si palë, duke përfaqësuar organin e akuzës ku ajo ka qenë gjyqtare e vetme ose anëtare e trupit gjykues.

- Në lidhje me shtetasin S. D., ai ka qenë prokuror, anëtar i Këshillit të Prokurorisë dhe më pas ka kaluar avokat. Pra, sipas subjektit, ai ka pasur njohje për shkak të punës, por jo raste trajtimi çështjesh me të.

Subjekti ka pretenduar, gjithashtu, se në asnjë rast nuk ka pasur ndërhyrje apo ndikim prej shtetasve të sipërpërmendur gjatë ushtrimit të funksionit si prokuror. Ndërsa sa i takon informacioneve të gjendura në mjetet e tij elektronike, sipas subjektit, të gjitha ato janë verifikuar nga Prokuroria e Posaçme dhe deri sot nuk është thirrur për të dëshmuar lidhur me këto fakte për të cilat, sipas tij, nuk është regjistruar ndonjë procedim penal.

95. Në vlerësimin përfundimtar të çështjes, pavarësisht pretendimeve të subjektit, i cili ka shpjeguar arsyet e kontakteve të çdolloji, konstatohet se ka konfirmuar njohjet me shtetasit e sipërpërmendur ashtu sikurse edhe me persona të përfshirë ose të dyshuar si të përfshirë në krimin e organizuar dhe në aktivitete të kundërligjshme në përgjithësi (trajtuar hollësisht gjatë vlerësimit të figurës). Në këto rrethana, referuar jurisprudencës së Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut dhe parimeve të Bangalorit, Komisioni vlerëson se kontaktet me shtetas të proceduar penalisht, si dhe kontaktet e shpeshta me politikanë apo njerëz të pushtetit ekzekutiv a gjyqësor, të cilat nuk justifikohen për shkak të ushtrimit të funksionit të një magjistrati, janë sjellje të pajustificuara dhe jo në përputhje me rolin, funksionet, detyrat dhe figurën e një prokurori dhe kanë gjithashtu një ndikim negativ në vlerësimin e etikës dhe vlerësimit të përgjithshëm të tij në kuadër të procesit të rivlerësimit sipas ligjit nr. 84/2016, duke cenuar besimin e tij në publik si pjesë e sistemit të drejtësisë.

96. Gjatë procesit të rivlerësimit përfundimtar të aftësive profesionale, në zbatim të pikës 1 të nenit 42 dhe të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016 dhe sipas parashikimeve të nenit 77 të ligjit nr.96/2016, Komisioni nuk mund të arrijë në përfundimin se subjekti i rivlerësimit është i

paaftë profesionalisht, por bazuar në të gjitha faktet dhe rrethanat arsyetuar hollësisht në këtë vendim, Komisioni vlerësoi se subjekti ka cenuar etikën e prokurorit për shkak se në dy raste ka trajtuar çështje në kushtet e konfliktit të interesit, si dhe për shkak të sjelljeve të përsëritura të pajustificuara dhe jo në përputhje me rolin, funksionet, detyrat, figurën e një prokurori, trajtuar hollësisht në këtë vendim, duke cenuar besimin e publikut te figura e tij si pjesë e sistemit të drejtësisë.

IV. SEANCA DËGJIMORE

97. Në datën 29.4.2022, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Theo Jacobs, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja. Gjatë seancës dëgjimore, subjekti i rivlerësimit shprehu qëndrimin e tij, duke dhënë sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e hetimit administrativ, procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, si dhe duke iu përgjigjur pyetjeve të drejtuara nga anëtarët e trupit gjykues. Në datën 6.5.2022 u zhvillua seanca, në të cilën Komisioni shpalli vendimin për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja.

V. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

98. Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46 të ligjit nr. 84/2016. Në komunikimet e tij, subjekti Arian Ndoja ka bashkëpunuar me Komisionin dhe ka qenë i gatshëm në kthimin e përgjigjeve, por gjuha e përdorur prej tij në përgjigjet e pyetësorit standard ka qenë me nota paragjyquese për punën e Komisionit. Më tej, gjatë seancës dëgjimore të datës 29.4.2022, subjektit iu tërhoq disa herë vëmendja nga trupi gjykues për përdorimin e një gjuhe joetike në drejtim të këshilltarëve që kanë punuar me çështjen, e cila çmohet e papërshtatshme.

VI. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

99. Në përfundim të procesit të rivlerësimit, bazuar në parimet e parashikuara në pikën 5, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, në Aneksin e Kushtetutës dhe në nenin 51 të ligjit nr. 84/2016 Komisioni vlerësoi që vendimmarrja për subjektin Arian Ndoja të bazohet në vlerësimin tërësor të rrethanave dhe procedurave, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr.84/2016, si vijojnë:

- U vërtetuan kontakte të subjektit me persona të përfshirë/dyshuar në veprimtari të kundërligjshme, një pjesë e të cilëve trajtuar nga Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Durrës.
- U vërtetuan dy raste të konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të detyrës përkatësisht me shtetasin E. Sh., person me precedent penal, si dhe vajzën e tij Z. Sh.
- U vërtetua cenimi i etikës së prokurorit gjatë komunikimit me Drejtuesen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Durrës, znj. A. J.
- U vërtetuan kontakte të subjektit me politikanë apo njerëz të pushtetit ekzekutiv a gjyqësor, të cilat nuk justifikohen nga ushtrimi i funksionit të një magjistrati.
- Subjekti i rivlerësimit ka pasur në dispozicion nëpërmjet mjeteve elektronike, të dhëna, informacione dhe kopje të dokumenteve, duke përfshirë dokumente të lidhura me hetime çështjesh, disa prej të cilave nuk ndiqen drejtpërdrejt prej tij.

KONKLuzion Përfundimtar

Në këto kushte, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u mbledh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “c”, të pikës 1, të nenit 58 dhe në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit Arian Ndoja, prokuror në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Durrës.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjektet e interesuara brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 6.5.2022.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Xhensila PINE
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli